

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 231, Janar 2023

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## GAZETA "DUKAGJINI" ECË PA U NDALUR ME DEKADA TË TJERA!

Me datën 30 dhjetor 2022, në mjediset e Bar-Restorant-Hotel "Tradita", me President Mjeshterin e Madh Gjon Dukgilaj, u zhvillua ceremonia e festes së 20 vjetorit të nxjerrjes së numrit të parë të gazetës "Dukagjini". Me datën 30 dhjetor 2003, në mjediset e Hotel "Rozafa" në prezencën e medias të kohës dhe dashamirëve të gazetës "Dukagjini", u paraqite numri i parë i saj. Një gëzim i ligjshëm i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e redaksisë së gazetës me në krye studiuesin, publicistin e poetin e humorit Prele Milanini.

### Malësorja e re dukagjinase

Marjana Koçeku, 22 vjeçarja nga Dukagjini, para disa ditësh bani bujë në mediat kombtare me historinë e saj sa të veçantë aq dhe frymëzuese. Malsorja e re nga fshati Mollë (Nanplep) i krahinës së Shoshit po frymëzon jo vetëm brezin e saj po këdo që e njih apo ka dëgjuar për të.

I ati i saj, Mark Molla, siç e rrëfen dhe Marjana, ka qenë kapiteni i parë në liqenin e Komanit dhe që të vogël, ...



### ARTILERIA NE FORCAT E ARMATOSUNA TË SHOQIPERISE, NE 102 VJETORIN E KRIJIMIT TE SAJ

Shpallja e Pavarësisë, me 28 nëntor 1912 e krijimi i shtetit shqiptarë pas gati 5 shekuj robërie nga pushtuesit otomane, është akti më madhor që rilindësit tanë të prirë nga Ismail Qemali, që realizuan në një kohë tepër të vështirë për gadishullin Ballkanik, i cili ishte përfshirë nga lufta e parë ballkanike dhe shqiptarët ishin në gjendjen e rende, se kishte renë perandoria otomane, rrezikonin ekzistencën e tyre nga oreksi i shteteve fqinj për pushtimin e copëtimit e saj. Një nga përparësitë e qeverisë të dale nga kuvendi i Vlorës, për kushtet aktuale ishte krijimi i ushtrisë, e cila u vendos në mbledhjen e 4 dhjetorit 1912, me emërimin e Gjeneral Mehmet Derralla, në postin e ministrit të mbrojtjes.



### PASHKU, SHKRIMTAR I RIPAGËZIMIT TË LETËRSISË SHQIPE

Në 81-vjetorin e lindjes së Anton

Pashkut (8 janar 1937-31 tetor 1995)

Me emrin dhe veprën e Anton Pashkut lidhet letërsia bashkëkohore shqiptare. Vepra e tij e ka madhësinë e shkrimtarit të së ardhmes. Ai na vjen si Modeli pashkian, që paraqet si vetëdije e pastër letërsiare, si vizion i rrallë në historinë e këndës dhe të letërsisë shqiptare.



### XHUBLETA E NGUSHTË E DUKAGJINIT TIPOLOGJI E VEÇANTË NË HARTEN ETNOGRAFIKE SHQIPTARE

Në përshkrimet e përgjithshme shkencore xhubleta e ngushtë Dukagjinit, është përmendur në mënyrë pothuajse empirike nga studiuesit vendas dhe të huaj pasi ajo përbën një sfidë më vete për faktin se gjendet shumë pak ose aspak në përdorim, gjë që e bën akoma më të vështirë deshifrimin e vlerave dhe veçorive të saj. Në të vërtetë kjo është edhe arsyeja ... / f.9

# Gazeta “Dukagjini” ecë pa u ndalur me dekada të tjera!

Me datën 30 dhjetor 2022, në mjediset e Bar-Restorant-Hotel “Tradita”, me President Mjeshtrin e Madh Gjon Dukgilaj, u zhvillua ceremonia e festes së 20 vjetorit të nxjerrjes së numrit të parë të gazetës “Dukagjini”.

Me datën 30 dhjetor 2003, në mjediset e Hotel “Rozafa” në prezencën e medias të kohës dhe dashamirëve të gazetës “Dukagjini”, u paraqite numri i parë i saj. Një gëzim i ligjshëm i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, e redaksisë së gazetës me në krye studiuesin, publicistin e poetin e humorit Prele Milanini.

Në këtë ceremoni feste, të 20-vjetorit të gazetës morën pjesë dashamirë të saj, gazetar dhe miq të gazetës e shoqatës, nga Shkodra, Nikaj-Merturi, Peja e Tirana.

Ceremoninë e hapë kryeredaktori i parë i gazetës Prele Milani, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, fjalën ja dha Kryetarit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, i cili theksoj:

## Të nderuar miq!

Mirë se keni ardhur në këtë ceremoni modeste, me rastin e vitit XX, që botohet gazeta “Dukagjini”!

Ju faleminderit, të gjithë juve, që jeni pjesë e kësaj ceremonie dhe jeni pjesë e gazetës “Dukagjini”.

Pasi bëmë prezantimin e themelimit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me 7 qershor 2003, përveç punëve të tjera bëmë përpjekje të nxjerrim gazetën, periodik i shoqatës, e pagëzuar me emrin “Dukagjini”.

Me 30, dhjetor 2003, në mjedisin e Hotel “Rozafa”, jemi mbledhur për të paraqite daljen e numrit të parë të gazetës. Ishin momente mjaft emocionues, aq sa pati nga pjesëmarrësit dukagjinasi, që u lotuan nga gëzimi. Edhe tani është një moment mjaft emocionues, që pas 20 viteve gazeta “Dukagjini” ka ecur, është botuar çdo muaj, dhe sot keni në duar numrin 230 të saj.

Një shprehje filozofike thotë: “Mos shko aty ku të shpie shtegu, por shko atje ku nuk ka shteg dhe lë gjurmë!” Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, kryesia e saj, redaksia e gazetës “Dukagjini”, vërtetë e filloi punën e saj në rrugë pa shteg, se, në radhe të parë asnjë nuk ishte profesionist, dhe së dyti, gjithçka ishte vullnetare, por vetëm e kishim të qartë misionin tonë, ishin atdhetar-intelektual, të ndërgjegjshëm për detyrën që i kishin vu vetës. Prandaj ndjehemi krenar para jush miq, për këtë arritje!

Dalja e kësaj gazete u bë e mundur, fale punës vullnetare të redaksisë së saj, në fillim me kryeredaktor mësuesin, oficerin e policisë, publicistin, poetin, shkrimtarin e studiuesin Prele Milani, pastaj kryeredaktor mësuesin, publicistin e poetin Lazer Kodra, më vonë kryeredaktor mësuesin e studiuesin Luigj Shyti, me vone me studiuesin e publicistin Suela Ndoja dhe së fundi me kryeredaktorin mësuesin

e studiuesin Luigj Shyti, me bashkëpunëtorët e tyre, Roza Pjetri, Suela Ndoja, profesor Zef Gjeta, mësuesin Zef Bari, shkrimtarin Lazer Stani, veprimtarin Luigj Mila, mësuesin e gazetarin Zef Nika, poetin Lulash Brigja, veprimtarin Ndue Ziçi dhe me shumë korrespondent të saj vullnetar ngado, që nga Australia e largët, SHBA, e kryesisht nga Miçigani, shtete të ndryshme të Evropës, si nga Greqia, Ital-

nga jeta e jonë, nga jeta e çdo dukagjinasi; është publikuar jeta e brezave tonë në shekuj, ngjarje atdhetare, ngjarje të drejtësisë, ngjarje të bashkëjetesës e të tjera; është shkruar natyrës tonë të mrekullueshme, si meza e Alpeve Shqiptare; i është shkruar dhe mundësive për zhvillimin e zonës së Dukagjinit; është publikuar e gjithë veprimtaria e jonë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, ajo e qytetit tonë,

me një shumë prej 147 000 leke; Anton Kosteri 5 here, me shumën 109 000 leke; Mhill Prroni 4 numra, me 80 500 lekë; Agron Hasanaj 3 numra gazete me një shumë prej 61 500 leke; Gjergj (Gjeke) Sokoli 3 numra gazete, me një shumë prej 60 000 leke; Gjergj Vocaj 3. 5 numra gazete, me një shumë prej 56 000 leke; Vatë Musa 3 numra gazete, me një shumë prej 57 000 leke; Pal Lera 3. 5 me një shumë prej 55



ia, Belgjika, Maqedonia, Kosova e Kosova Lindore, Mali i Zi; ndërsa brenda shqiptarisë kemi nga Shkodra, Tirana, Gjirokastra, Mirdita, Peshkopia, Lezha, Kurbin, Malësia e Madhe, Nikaj-Merturi e të tjerë e të tjerë. Plote 592 autore, me nga një material e deri me 247 materiale, kampionin Prele Milani; me plotë 3 249 artikuj të ndryshëm: Për kulturën tradicionale dhe bashkëkohore, 686 artikuj, që zënë 21 %; Portrete të ndryshëm 733 artikuj, që zënë 22 %; mbi problematika 595 artikuj, që zënë 18 %; mbi krijimtarinë nga tradita e bashkëkohorja 407 artikuj, që zënë 13 %; mbi veprimtaritë e ndryshme 373 artikuj, që zënë 12 %; mbi përshkrime historike e natyrore 357 artikuj, që zënë 11 %; mbi zhvillimin e arsimit në përgjithësi dhe në veçanti, në Dukagjin 98 artikuj, që zënë 3 %.

Gazeta “Dukagjini” ka luajtur rolin e një tribune nga e cila u është bërë thirrje gjithë dukagjinasi për shkollimin e fëmijëve të tyre, për tu ndarë njëherë e mirë nga mendësitë orientale, që do të thotë: UNI, PËRJASHTIMI dhe AI; ju bë jehonë figurave të 40 Martirëve për fe e atdhe, që sot janë të lumnuem dhe 9 prej tyre janë dukagjinasi; janë publikuar të gjithë ata krijues popullor, artist, studiues, botues e publicist për punën e madhe që kanë bërë; janë ngritur dhe mos vlera, të cilat i ka krijuar koha dhe koha duhet ti largojë

Shkodrës, të artistëve, të shkrimtareve, të poetëve, të veprimtarive të bibliotekës “Marin Barleti” e të tjera pa fund; janë publikuar krijimtaria artistike, këngët dhe veprimtaritë artistike dhënë në teatrin “Migjeni”; është publikuar e gjithë pjesëmarrja e bashkëpunimi me motrat tona në Kosovë, me Shoqatën e vëllazërisë Kosovë – Malësi e Madhe e pagëzuar me emrin “Martin Dreshaj”; në Mal të Zi, në veçanti me Shoqatën “Dede Gjon Luli”; në Kosovën Lindore, në Rrozhajë, me klubin letrar “Ora e Maleve”; në Istog, me klubin “Ora letrare”; në Peje e në Deçan, në Prizren e në Klinë, në Skenderaj e në luginën e Rugovës, në Tuz e në Ulqin.

Kjo gazete në çdo muaj ka pas një gjëmim jo të vogël, me 16 deri 20 “rrufe”, në të mirë të bashkësisë sonë prej nga jemi, në të mirë të bashkësisë ku jetojmë.

Gazeta “Dukagjini” nuk mund të dilte pa kontributin financiar të 97 kontribuuesve. Këta kane harxhuar nga munda e djersa e tyre, gjithsejtë 4 889 242 leke, që nga 2000 leke e deri më 1 550 000 lekë. Më kryesorët janë: Gjergj Leqezja, me 1 550 000 lekë, për botimin e 57 numra të gazetës; Ndue Ftoni, me 43 numra gazete, me një shumë prej 916 300 leke; Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” 28 here, me një shumë prej 228 240 leke; SIGMA për 113 herë, me 226 000 leke; Kole e Gëzim Çardaku, 8 numra gazete,

500 leke; Pal Gjollaj 2. 5 numra gazete, me një shumë prej 47 000 leke; Bal Vuksani 3 numra gazete, me një shumë prej 45 000 leke dhe të tjerë e të tjerë. Mirënjohje për të gjithë! I urojmë me shprehjen popullore “Paçin e dhënçin!”

Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në emër të Kryesisë së saj, në emër të redaksisë së gazetës, të gjithë artikull shkruarit dhe të gjithë mundësorëve financiar, ju premtojmë, se gazeta “Du-



kagjini” do të eci pa u ndalur në misionin e saj, për të ndikuar sa të jetë e mundur në edukimin e shoqërisë, në emancipimin më shumë të saj.

Gazeta “Dukagjini”, për ecurinë dhe kontributin e saj, me datën 27 prill 2022, nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Qarku Shkodër, në edicionin e pestë të saj, është nderua me çmimin “**Hamit Boriçi**”.

Për përgatitjen e zhvillimin e kësaj ceremonie kontribuuan financiarisht zoti Gjergj Leqejza, Kolë Çardaku, Anton Kosteri, Pal Shkambi, Mark Mici (në Nju-Jork), Gjon Dukgilaj, dhe File Strugaçi, të cilët i falënderojmë dhe ju themi: Paçi e dhënçi!

Në mbyllje ju themi “GEZUAR e me faqe të bardhë në të ardhmen e kësaj gazete!

Ju uroj gëzuar vitin e Ri- 2023, me plote mbarësi e mirësi në jetën tuaj, në jetën e familjeve tuaja dhe me faqe të bardhe në punën tuaj të përditshme në shërbim të bashkësisë shkodrane e shqiptare.

\*\*\*

Me këtë rast, kryesia e shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me datën 10 dhjetor 2022, me vendim nr. 270, vendosi të nderojë disa nga bashkëpunëtorët e gazetës “Dukagjini”, të cilët u dhanë në këtë ceremoni:

\*Zoti **Lazër Kodra** u nderua me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Pjeter Rushaj**, pas vdekjes, u nderua me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Kryetarja e shoqatës kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptarë”, zonja **Rita Shkurtaj**, u nderua me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Meritan Spahia**, u nderua, me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Mhill Vata**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Gëzim Brahusa**, Presidenti i TV “Blue Sky, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zonja **Gjyste Çarku-Bici**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zonja **Kozeta Bruçi**, gazetare në TV1-Top-Chennel, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Mark Gjeka**, gazetar, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Gasper Marku**, gazetar sportiv, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Lulash Gjeloşi**, pronar i bar-restorant “Floga”, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Tomë Arra**, pronar i bar-restorant “Orlando”, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Pjeter Gjeta**, pronar i bar-restorant “Blini”, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Fran Shytani**, mjeshtër në punimin e gurit (ART-TRADIT), u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Poeti **Lulash Brigja**, anëtar i redaksisë së gazetës “Dukagjini”, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare



Dukagjini”;

\*Zonjusha **Klodjana Serraj**, anëtare e kryesisë dhe e redaksisë së gazetës “Dukagjini”, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Doktor **Ndue Nikaj**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Poete **Bona Mulaj-Lluka**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Doktor **Mark Bobnaj**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Ndue Ziçi**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Kolonel **Flamur Muça**, në pension, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*N/kolonel **Dede Zhivani**, në pension, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Zoti **Agron Përbibaj**, gazetar, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”;

\*Major **Gjon Bruçi**, në pension, publicist, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”;

\***RTSH-dega Shkodër**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”;

\***Poetja Kumrie Shala**, u nderua me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”;

\*\*\*

Pastaj përshëndetën:  
Zoti Zef Gjini, kryetari i Shoqatës “Mirëdita”-dega Shkodër;  
Zoti Gjin Niklekaj, në emër të Shoqatës

“Nikaj-Merturi”;

Zoti Muammar Vuçi, Kryetar i shoqatës me vendet Arabe;

Poetja Mimoza Rexhvelaj;

Koloneli në pension Vuksan Vukaj, në emër të Shoqatës së ushtarakeve në lirim e në pension-dega Shkodër;

Mjeshtri i Madh, Gjon Dukgilaj, në emër të bar-restorant-hotel “Tradita”;

Zoti Rrahman Jashari, koordinatori i Shoqatës së vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe, “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, i cili në mes të tjerëve, theksoi:

“**Dritare e hapur e Dukagjinit, për Dukagjinin dhe gjithë trojet shqiptare.**

*Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në rrugëtimin e saj nëpër vite ka shënuar arritje të larta, duke ruajtur e promovuar vlerat letrare e artistike, me të cilat krenohet kjo pjesë e Shqipërisë, por edhe gjithë trojet shqiptare. Në rrjedhën e këtyre veprimtarive është edhe ky moment solemn, për të shënuar datën e madhe të gazetës “Dukagjini”, e cila po shënon 20 vite të rrugëtimit, duke qenë dritare e hapur e Dukagjinit për Dukagjinin dhe gjithë trojet shqiptare. Në takimin solemn kushtuar kësaj date të rëndësishme miq jo vetëm të kësaj ceremonie, por të përhershëm jemi dhe ne të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me ne krye Kryetarin Ukshin Jashari bashkë me anëtarët e kryesisë, poeten Kumrie Shala e Rrahman Jasharaj.*

*Në hapje të këtij takimi solemn kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” Ndue Sanaj bëri një përshkrim të rrugëtimit për 20 vite të gazetës së përmuajshme për të shprehur respekt meritore për anëtarët e redaksisë, bashkëpunëtorët dhe për gjithë ata që mbështeten botimin dhe rrugëtimin drejt lexuesve të kësaj gazete.*

Pas kësaj janë ndarë tituj nderi të veçanta për shumë individë, që ishin pjesë e rrugëtimit të gazetës “Dukagjini”. Mes të nderuarve me mirënjohje ishte edhe anëtarja e kryesisë së Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, poetja Kumrie Shala, e cila kishte bashkëpunuar me gazetën duke dërguar poezi të zgjedhura për botim. Kumrija duke marrë mirënjohjen foli me plot emocione e duke treguar se ndjehet e nderuar për mirënjohjen dhe për mundësinë që redaksia e gazetës “Dukagjini” i ka dhënë që poezitë e saj të lexohen nga lexuesit e shumtë të kësaj gazete.

*Duke përgëzuar Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” për gjithë veprimtaritë dhe për këtë datë të shënuar, u përcjell përshëndetjet dhe përgëzimet në emër të gjithë anëtarëve të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, duke shtuar se gazeta “Dukagjini” ishte dhe mbetet dritare e hapur e Dukagjinit për Dukagjinin dhe gjithë trojet shqiptare.”*

Nga zoti Rrahman, në emër të Shoqatës “Martin Dreshaj” redaksisë së gazetës “Dukagjini” i dha titullin “Mirënjohja e Shoqatës Martin Dreshaj”.

\*\*\*

Kjo ceremoni u mbyll me nga një gotë verë, e dhënë nga i zoti i shtëpisë, Gjon Dukgilaj!

**Roza Pjetri,  
Klodjana Serraj e  
Dukate Bregu**

# Malësorja e re dukagjinase



Nanplep, nëntor 2020

Marjana Koçeku, 22 vjeçarja nga Dukagjini, para disa ditësh bani bujë në mediat kombtare me historinë e saj sa të veçantë aq dhe frymëzuese. Malsorja e re nga fshati Mollë (Nanplep) i krahinës së Shoshit po frymëzon jo vetëm brezin e saj po këdo që e njih apo ka dëgjuar për të.

I ati i saj, Mark Molla, siç e rrëfen dhe Marjana, ka qenë kapiteni i parë në liqenin e Komanit dhe që të vogël, Marjanën e ka pasë shoqëruese në atë liqen, në varkë dhe për peshkim. Ajo flet me krenari për prindërit e saj që janë munduar të tejçojnë tek ajo vlerat dhe fisnikërinë malsore. Nana e Marjanës, Dalina nga fisi i Kapajve të fshatit Toplanë, ka qenë frymëzimi dhe shembulli i saj më i madh në jetë. Jo vetëm për vlerat e trashëguara njerëzore por edhe për punën e palodhshme dhe dashurinë e saj.

## Kush është Marjana Koçeku?

Marjana, e datëlindjes 16 nëntor 2000, ishte vajza e vogël e shtëpisë, por me andrra të mëdha. Kreu gjimnazin në Shkodër tek ish kolegji saverian "Atë Pjetër Meshkalla", aty ku u edukua Mjeda, Arshi Pipa, Fishta e shumë personalitete kombtare të kalibrit ma të naltë intelektual e shpirtëror.

E rritur mes Shkodrës dhe Dukagjinit ajo shprehet se, ishte me fat që u rrit në një familje malsorësh ku vëllezërit e saj ishin dhe të parët që filluan turizmin në liqenin e Komanit dhe e bënë atë mjedis të famshme ndërkombtarisht.

Marjana, studimet e larta i kreu midis Tiranës dhe Gjenovës, ku falë bursës së Bashkimit Evropian, "Erasmus +", përveç eksperiencë akademike, ajo mori dhe një eksperiencë të vlefshme jete, që i bëri të mundur shumë udhëtime në vende si Franca, Italia, Zvicra e më pas Çekia, Austria e Suedia.

Gjatë studimeve, por jo vetëm, Marjana ka spikatur në veprimtari e projekte rajonale dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrëse në shumë konferenca dhe projekte brenda dhe jashtë vendit, i bënë të mundur asaj aftësimin e mëtejshëm dhe përafrimin më ëndrrën e saj, për tu bërë diplomate. E diplomuar me ekselencë dhe meritë akademike, Marjana papritur do të merrte një kthesë të fortë në jetën e saj, kthimin

në fshatin e origjinës, duke refuzuar kështu shumë oferta dhe mundësi të ëmbla të perëndimit.

Çfarë e shtyu Marjanën të lërë Evropën dhe të kthehet tek rrënja e saj?

Mënyra se si e kish rritur nëna, fjalët e urta dhe urtësia malsore, pasuritë natyrore e njerëzore e bënë atë që të dashurohej dhe më shumë me Dukagjinin pavarësisht largësisë.

Ajo thekson: "U ktheva se askund nuk je ma e lirë se në shtëpinë tande". Si duket, Dukagjini, dashuria e saj më e madhe, kulla që i trashëgoi gjyshi dhe babai e bënë Marjanën të kthejë kokën mbrapa tek të parët e saj. Ajo flet me adhurim për historinë dhe traditat e malsisë së saj, për doket e zakonet duke e konsideruar Dukagjinin një ekzemplar botëror vlerash njerëzore e natyrore. Në një kohë ku Shqipëria po përballet me largimin e të rinjve në mënyrë masive, Marjana është një troftë e egër lumi, që i pëlqen të shkojë kundër rrymës së egër dhe tjetërsuese.

Ajo vendosi ti thotë Evropës "tu rritë

ndera" e "t'njështa t' mirën"!

Miqtë dhe jo vetëm e njohin si Neomalsorja (Malësorja e Re). Ajo shpjegon më tej se ky term është një koncept që do të thotë kthimi i rinisë tek rrënja, gjë të cilën Marjana po e përfaqëson mesë miri. Së bashku me dy vëllezërit e saj dhe nënën janë të angazhuar në turizëm në fshatin e tyre tek kulla e të parëve që ndodhet në hyrje të lumit të Shalës. Me ofrimin e shërbimeve të bujtinës, restorantit dhe varkave, ata janë vizituar nga mijëra turistë nga e gjithë bota. Ky ka qenë një privilegj për Marjanën, që të rritet aq larg, por dhe aq afër botës midis kulturave të ndryshme.

Sot, në vendin e saj, Marjana ndjehet krenare dhe e lumtur. Edhe pse në zonën e saj mungon energjia elektrike që 25 vjet dhe nuk ka valë telefoni apo internet, ajo thotë që kthimin në natyrë dhe identitet është gjëja më e rëndësishme dhe plotësuese. Ajo nuk e ka aspak për turp, por vetëm krenari që të punojë tokën, të punojë me kafshët e fermës dhe të marrë dru në mal, për gatimin dhe ngrohjen me zjarr.



Nanplep, gusht 2022, me nipat Noelin, Markun dhe mbesen Marinën



Euronews, Tiranë, 2022

Gjatë dimrit ajo jeton edhe në Shkodër, ku ka thuarse gjithë të afërmit dhe miqtë e saj. Ajo e konsideron tepër të rëndësishme rilidhjen me tokën dhe vetveten si rrjedhojë.

Marjana padyshim është një ogur i mirë për të gjithë rininë shqiptare, e cila të ri-mendojnë zgjedhjet e tyre dhe mos ta mbajnë kokën drejtuar vetëm ka Evropa, por që me ide të reja dhe inovative ti kthehen origjinës dhe rrënjëve.

Çmimet e fituara:

\*"I riu i muajit" nga Agjencia Kombëtare për Rininë, dhjetor 2022

\*Vlerësuar me certifikatë ekselence nga universiteti Barleti me rastin e 100 vjet parlamentarizëm, 2019

\*Vlerësuar si "Delegatë e Jashtëzakonshme" në konferencën tre ditore "Modeli i Bankës Botërore" nga Këshilli Rinor i Ballkanit (Ballkan Youth Council)

## Veprimtari të kryesore angazhuese të Marjanës:

\*Pjesëmarrëse në konferenca dhe projekte rajonale dhe ndërkombëtare

\*Bashkëorganizatore e "30 vjet Martin Camaj - 30 vjet letërsi e vazhdimësisë: 1992-2022", Vjenë, mars 2022

\*Pjesëmarrëse në seminarit e lider-shipit "Një brez i ri i liderëve të dialogut në Mesdhe" nga Anna Lindh Foundation dhe Akademia për studime diplomatike në Mesdhe

\*Alumni e shkollës së Ballkanit Perëndimor për pjesëmarrje rinore dhe integrim evropian, POLITEIA, Montenegro

\*Pjesëmarrëse në konferencën rajonale "Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor dhe politikën rinore" Beograd, nëntor 2019

## Publikime:

\*Bashkëautore e broshurës "Historia dhe edukimi mbi të drejtat e njeriut", botuar nga Youth Act Center, Tiranë dhe mbështetur nga World Vision dhe South East European Youth Network

\*Jeta jonë gjatë pandemisë, publikuar nga ALDA Balkan youth

\*Të drejtat e grave në Shqipëri gjatë historisë, publikuar në blogun The Balkanista

\*\*\*

Kjo është Marjana Koçeku, Malësorja e Re dukagjinase, një shembull i padiktueshëm për të rinjtë e të rejtat dukagjinase e mbare kombëtare, se siç shprehet vetë ajo: "U ktheva se askund nuk je ma e lirë se në shtëpinë tande, në Dukagjinin tande!"

\*\*\*

Marjana, Malësorja me e Re dukagjinase, të urojmë punë të mbarë, me mendje të kthjelltë e këmbë të lehta në shërbim të misionit tuaj, dhe sa më shpejt dhe me sa më shumë u bëfshi me shoqe e shokë dukagjinase!

Ndue Sanaj

# FAMILJA THEMEL DASHURIE

*“Kur familja është e shëndoshtë, Kisha dhe Shqipëria janë të forta dhe e ardhmja do të jetë e lumtur”*

**Pader Kolë Thaqi Ofm**

Duke marr shkëndinë e parë nga predikimi i Pader Kolës në Meshën e së Dielës, në Kishën e Zojës Ruzare në Shkodër, më lindi ideja që të filloja një cikël të ri bashkëbisedimesh gjatë këtij viti, që është e 20 vjetori i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Duke qëndruar aty, në Kishë takova Violën Shqau dhe thashë më vete. - Ja personazhi i parë që ja vlen të bashkëbisedoj. Si gjithmonë e gatshme për të dhënë më të mirën e saj Vjola, me kënaqësi pranoj.

-Viola ju falënderoj, që krahas angazhimeve të shumta që keni, po na dhuroni kohën tuaj për këtë bashkëbisedim për gazetën “Dukagjini”. Në fillim të këtij viti që është edhe jubilarë për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” (20 vjetorin e veprimtarisë së saj). Me këtë rast vendosa, që çdo muaj të kemi një apo dy bashkëbisedime, me dukagjinat, që janë vlerë për familjen, shoqërinë dhe krejt Dukagjinin.

Po e filloj me ju Viola si nënë e suksesshme, grua e fisnikë, intelektuale dhe artiste e zonja.

-Roza së pari të falënderoj për zemërsisht për bashkëbisedimin dhe vlerësimin. Së dyti Shoqatës Atdhetare «Dukagjini» i uroj jetë të gjatë sa vetë malet e tij

**-Viola, je e dashur, e nderuar dhe respektua në qytetin tonë e më gjerë. Gjë që ju e keni arritur fal virtyteve, që të ka dhuruar Zoti, familja dhe këmbëngulja juaj për të arritur të mirën, të bukurën dhe suksesin. A mund të na njihni më gjerësisht me jetën tuaj?**

-Viola Shqau është një bije Shllaku e lindur në fshatin Benë, në një familje me besim të madh në Zot, në një familje artdashëse, e bija e Ndocit dhe e Lules, motra e një vëllai dhe tri motrave. Të dy prindërit e mijë ishin artistë amator. U rrita në një familje ku kryefjala ishte dashnia dhe respekti për njëri tjetrin!

U rrita në një familje ku falënderimi dhe lutja ndaj Zotit ishte e përnatshme. Them kështu ngaqë në mbrëmje ishim të mbledhur të gjithë në lutje dhe pse më frikën e kohës... U rrita mes tingujve burimor të folklorit.

Jam e martuar në fshatin Vukaj të Shllakut, në një familje të njohur në gjithë Dukagjinin e me gjerë, familja e Ndoc Mhillit, ose siç quhej ndryshe familja e Ndoc Begut. Jam nëna e 4 fëmijëve, një djali dhe tri vajzave për të cilët jam shumë krenare. Vajza madhe, Edmira e diplomuar në Vjenë – Austri; Enkolina diplomuar në Sapienza, Romë; vajza e vogël, Klea, vijon studimet në Romë; ndërsa djali, Klesti jeton në Kanada dhe krahas punës vijon dhe studimet.

**-Viola cili është çelësi juaj që keni ndërtuar një familje të mrekullueshme, të cilën e pasqyrojnë më së miri edhe arritjet e fëmijëve tuaj? Të diplomuar në**

**fakultet të vendit dhe Evropës me rezultate mjaftë të mira. Duke pasur parasyshe edhe kohën që po jetojmë ku familja ndodhet në udhëkryqe të mëdha....**

- Më besoni, që ka qenë shumë e vështirë dhe sflitëse, por gjithmonë jam udhëhequr nga besimi në Zot, nga modeli i familjes në të cilën u rrita, dashnia dhe të qëndruarit pranë tyre.

**- Prej shumë vitesh punoni pranë**

**famullisë së Zojës Ruzare dhe aktivizoheni me Shoqin Kulturorë “Illyricum”. Lidhja ju me Kishën dhe porosia juaj për Dukagjinat, ku sot për fat të keq disa i shohim larg Kishës?**

-Po, kam 13 vite që punoj si sekretare e Provincës Françeskanë, famullia “Zoja Ruzare”- Shkodër. Siç e theksova më lart, jam rrit në një familje të krishtere, ku urata ishte ushqimi i përditshëm. Në

Shoqin Kulturorë “Illyricum” u aktivizova që në fillimet e punës sime në Provincë nga ku kam marr eksperiencën të mëdha për sa i përket artit.

Porosia ime?! -”Zoti është ai që na do pa interes dhe që nuk na braktis kurrë. Bëni vend në zemrën dhe jetën tuaj”

**-Si nënë dhe si artiste, cili është mesazhi juaj për kohën, e cila po lejon rinin të ikën nëpër botë?**

-Aha, këtu më keni prek shpirtin! Është e dhimbshme kjo që ka ndodh dhe po vijon të ndodh për fat të keq! Të gjitha nënave u them: Mbani afër fëmijët tuaj sa janë të vegjël, faluni shumë dashni. Nesër kur të largohen lutuni: Zoti i pastë në dorë! Si artiste u kam kushtuar një këngë, me titull “Ku i ka nena fëmijët e vet”, besoj se e ka mesazhin në brendësinë e vargjeve të saj.

**-Ka disa vite, që jeni anëtare e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe kohët e fundit jeni anëtare e Kryesisë, mendimi juaj për veprimtarinë e saj dhe a të ka penguar angazhimi juaj të kontributoni edhe në veprimtaritë e saj?**

-Po ka shumë vite që jam pjesë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe jam tash rreth pesë vite anëtare e Kryesisë, që mbuloj veprimtaritë artistike, për këtë jam krenare, që

jap sado pak kontributin tim. Ka momente që nuk mund të jem prezentë, por kjo ndodh për arsyen e angazhimeve tjera.

**-Veprimtaria juaj si këngëtare, e cila çdo ditë e më shumë po ka suksese dhe përmend këtu edhe pjesëmarrjen tuaj në Dhjetor 2022, në koncertin që u organizua nga Dukagjinat në Nju-Jork, ndjesia e juaj?**

-Veprimtaria ime ka qenë disi më e dukshme këto vitet e fundit ngaqë fëmijët u rritën dhe u shkolluan, kam pasur më shumë kohë për t’ju përkushtuar këngës, dashurisë sime. Udhëtimi drejt Nju-Jork ishte një eksperiencë ndryshe që më dha shumë mundësi njohje dhe që do ketë shumë fryte.

**-Në përfundim të këtij bashkëbisedimi, Viola duke ju falënderuar edhe një herë për këtë bashkëbisedim dhe duke ju uruar suksese të mëtejshme. Mesazhi juaj si nënë e suksesshme, si grua fisnike dhe artiste?**

-Mesazhi im është: Familja është e shenjtë, falni shumë dashni në familje, që të kemi një shoqëri më të mire! Mos i vritni ëndrrat tuaja, punoni shumë për ti realizuar! Faleminderit dhe suksese gazetës “Dukagjini”

**Bashkëbiseduesja  
ROZA PJETRI**



*Familja Viola e Tush Shqau.*

*Nga e majta në të djathtë: Edmira, Enkolina, Viola, Tushi, Klesti dhe Klea*



# Ramush Nikçi në bibliotekën “Marin Barleti”

Me 15 janar 2023, dite e Diele, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Drejtorin e Bibliotekës “Marin Barleti”, zotin Maxhid Cungu, organizoi ceremoninë e promovimit e tre vëllimeve me poezi, të autorit Ramush Nikçi, me banim në Pejë.

Zoti Ramush u paraqit mjaft mirë me vëllimet e tij poetike. Ishte një ëndërr e kahershme e autorit për të promovuar në Shkodër krijimtarinë e tij dhe ja u bë realitet.

Fjala e hapjes nga kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” z. Ndue Sanaj ishte një mesazh mirëseardhje dhe një vlerësim për bashkëpunim me artistë nga Kosova.

Puna e tij artistike krijuese u vlerësua mjaft seriozisht e me kompetencë nga folësit, si poeti e veprimtari Ali Daci, Historiani e Poeti Nikollë Loka, poetja Bona Mulaj, poeti Lulash Brigja, poetja Ganimete Thaçi dhe poetja Farida Ramadani.

Në fjalën e tij z. Loka tha se, këto vëllime me poezi kane vlera të veçanta artistike, por edhe gjuhësore, sepse autori me mjaft mjeshtëri ka përdorur fjale dhe shprehje të rralla, që në fjalorin tone të përditshëm janë drejt zhdukjes.

Një tjetër moment i veçantë ishte, kur Mjeshtri i Madh, Ilmi Kurti dha tituj nderi “Ambasador të Paqes”, për Kryetarin e shoqatës kulturore “Besa Shoshi”, rapso-din Ndoc Fusha dhe poetin e veprimtarin Lulash Brigja.

Kjo veprimtari promovuese e poetit nga Peja, u drejtua me plotë kompetencë e kulturë nga zonjusha Pamela Marashi!

Mirë u takofshim në veprimtari të tjera!

\*\*\*

## Fjala, në këtë promovim e poetit Lulash Brigja:

Mirë se jemi bashkuar në këtë festë poetike shqiptare.

Them festë, sepse çdo promovim libri apo veprë artistike është një festë, se për



të mbërritur deri këtu janë dashtë shumë orë punë, shumë përvojë, frymëzim, kosto, e të tjera, e të tjera.

Prandaj promovimi i një libri është së pari festë, pastaj recension apo vend për kritikë letrare.

Them Shqiptare, sepse këtu kemi nga Rozhaja, nga Rugova, nga Peja, nga Mirdita, nga Lezha nga Malësia e Madhe dhe Shkodra.

Shkodra mbetet ajo toka e premtuar e artit dhe kulturës Shqiptare.

Prandaj miku im Ramush Nikçi, Mirë se erdhe në Shkodër, për të sjellë vargjet e



tua poetike, të cilat nuk janë pak, tre vëllime me poezi:

- “Melodi kujtimesh”
- “Shtigje ëndrrash të trishta”
- “Jehonë bjeshke”

Faleminderit, që zgjodhët Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Bibliotekës “Marin Barleti” dhe mua personalisht për të koordinuar këtë takim të veçantë mes jush dhe artistëve të Shkodrës.

Faleminderit, Patriotit dhe misionarit të flaktë të çështjes kombëtare Shqiptare z. Ali Daci.

Jo vetëm si redaktor i tre librave me poezi por edhe si personazhi kryesor që mban lidhjet miqësore dhe poetike midis Shkodrës dhe Kosovës.

Para se të vijoj me opinionin tim mbi veçoritë artistike të poezisë të autorit gjithmonë sipas syrit tim, dua të citoj etjen e vjetër të poetit Ramush Nikçi, dhe besoj se kam kuptuar mirë, se komplet brezi i tij janë rrit me një mall vlerësim dhe dashuri për Shkodrën.

Kjo shprehet tek kjo poezi e shkruar ndoshta shumë vite më parë.

## BUZËQESHJE SHKODRANE

Mjaftojnë këto vargje për të kuptuar se sa e vlerëson, sa e dashuron dhe sa e ka ëndërruar autori këtë ditë, për të promovuar këtu tre vëllimet e tij me poezi.

Për vlerat artistike të vëllimeve tuaj folën kolegët, që mendoj se pas analizës poetike e letrare ,që bëri poeti dhe historiani Nikollë Loka, apo kolegja jonë Bona Mulaj, mua më mbetet pak për të thënë.

Por do të citoj disa veçori poetike dhe artistike që mua si lexues, pastaj edhe si krijues, më bëjnë përshtypje te vargjet e poetit nga Peja z. Ramush Nikçi.

1. Së pari, më bën përshtypje se sa bukur e përdor vargun si armë për të dhënë mesazh, por edhe për të luftuar fenomenet shoqërore me të cilat ne bashkëjetojmë.

2. Unë mendoj se talenti dhe pasioni lindin bashkë me ne.

Autori i tre vëllimeve, që sot po promovojmë, mendoj se për arsyet e veta iu

shmang për shumë vite këtij talenti. dhe ja ku erdhi një fazë, që talenti dhe pasioni triumfoi mbi njeriun dhe për një kohë krejt të shkurtër, shpërthen me tre vëllime me poezi.

Poezitë e tij nuk kanë adoleshencë, përvoja e tij, formimi njerëzor dhe intelektual e bëjnë atë të duket në çdo poezi si një profesor. Vargjet e tij kanë pjekuri, kanë peshë dhe mesazh. Prandaj janë edhe interesante për tu lexuar.

3. Frymëzimi dhe formimi poetik i autorit, mendoj se i ka bazat tek formimi profesional i tij tek mosha rinore e studimeve të tij.

Në atë kohë, në Kosovë lulëzonte Shkolla poetike e Esat Mekulit, Ali Podrimja, Anton Pashku apo Sabri Hamiti. Mendoj se, duke lexuar dhe studiuar këta autorë, z. Nikçi mori jo vetëm shkollën e tyre, por edhe frymëzim për të shkruar.

Ai është diplomuar për Gjuhë Letërsi, por për të dalë në publik me libër të mirëfilltë, duket se është bindur vetëm vitet e fundit.

Pra, dua të them se tek vargjet e autorit që kemi sot këtu gjejmë pak nga secili prej atij brezi të artë të poezisë Shqipe në veçanti, që lulëzoi në fundin e shekullit të kaluar. Të njëjtën gjë mund të themi për poetin lezhjan të viteve ‘90 me Preç Zogaj, Rudolf Marku apo Ndoc Gjetja, që ishin frymëzim për ne.

4. Një cilësi tjetër e stilit poetik të z. Nikçi, është metrika dhe thjeshtësia e vargut. Shoh që autori përdor me lirshmëri çdo gjatësi vargu. 8 ..12 apo edhe me shumë rrokjesh, duke ruajtur gjithmonë rimën brenda poezisë, por edhe formatin AA ..ose AB. Kjo falë formimit gjuhësor, por edhe duke shërbyer si pikë referimi për nxënësit e tij apo lexuesit.

5. Te tre vëllimet e autorit kanë datëlindje të përafërt, kanë të njëjtin stil, por ndryshojnë pak tek tematika. Mendoj se autori fillimisht ka dashur të krijojë bahçen e tij të relaksit, kopshtin e tij shpirtëror dhe të hedhë aty botën e tij të brendshme, por pak nga pak ka pa se, bota e tij artistike është më shumë se vetë Ramushi. Është bindë që të botojë, kur ka pa se lumin e tij poetik nuk e zë një libër, iu desh të botojë tre të tillë. Nuk do zgjatëm që të analizojmë veç e veç secilin, por do të vë në dukje edhe dy tre cilësi që vërej tek poezia e z. Ramush Nikçi.

6. Natyra, njeriu dhe e bukura

Autori është një Rugovas, nga një vend me ideal për frymëzim, një poet ose piktor, nuk mund të gjej sesa ato bjeshkë, prandaj natyra zë vend të veçantë në poezitë e tij. Në qoftë se natyra i bëri nder atij duke e frymëzuar, duke ia mbush shpirtin dhe mendjen me ide bio. Autori i bën nder lexuesit, sepse e sjell Rugovën tek lexuesi, me borë, livadhe, lule, zana, drerë dhe flutura.

Njeriu i thjeshtë, njeriu shembull ose model, është personazh i vijueshëm. Pse? Sepse autori nuk është produkt abstrakt, që një ditë vendosi të bëhet poet. Ai vjen nga jeta reale. Ka pa luftën, ka përjetuar eksodin e krejt Kosovës, ka pa sesi çel lulja edhe në borë edhe mbi gërmalla. Pra me pak fjalë autori ka marrë botën e

# Sofra e Dukagjinit - 2023

Me datën 29 Dhjetor, në ambientet e Bar Restorant "Antika" u zhvillua veprimtaria, me titull "Sofra e Dukagjinit-2023".

Nga viti 2017, kjo feste është kthyer në traditë, në veprimtarinë më të rëndësishëm të muzikës folklorike tradicionale

nale e përsëritur vit pas viti.

Një nga gjërat më të vështira në organizimin e veprimeve të tilla, sidomos tradicionale është ruajtja e autentikes asaj për të cilën kemi të gjithë krenare dhe duhet ta përcjellim brez pas brezi si dhe



të Dukagjinit dhe më gjerë.

Nen kujdesin e presidentit e asaj që tashme quhet Shoqata 'Sofra e Dukagjinit' z. Vuksan Xhuri, nën kujdesin artistik të dhe tekst shkruarit z. Lulash Brigja si dhe drejtuesit organizativ z. Marjan Nder-shiqaj, të cilët kujdesen që gjithmonë të sjellin më të mirën e publikut si dhe risi. Mund të themi se risia më e madhe ë këtij viti ishte mbajta e sofrës së Dukagjinit edhe në Londër, e cila premtim se do të kthehet edhe ajo në një shfaqje tradicio-

ndërthurja e saj me të rene, me kohën modern, me zhvillimin dhe emancipimin, si dhe mund të themi se sofra e Dukagjinit ia ka arritur më së miri ta bëjë atë.

Janë disa elemente që e bëjnë këtë veprimtari të suksesshëm për të disatin vit radhazi:

Fillimisht janë këngëtarët, që gjithmonë janë të pranishëm ato që kanë ndër-tuar histori në muzikën tradicionale, janë ikona që do njihen për breza të tërë.

Pastaj një nga veçoritë që ka kjo sofrë,

brendshme të shumë njerëzve dhe e ka ba poezi.

E bukura ... Mundem ta ndaj në dy kategori këtë tipar të poezisë së autorit: E bukura lirike dhe e bukura njerëzore.

Lirikat e tij janë bjeshkatore, janë të mbushura me figura letrare dhe me fjalë të pastra shqipe.

Ndërsa e bukura njerëzore shpirtërore vjen me nëntekste dhe subjektet i gjen kudo, tek një lule, tek një profesion i thjeshtë tek një zog që ka mbet në borë..

7. Unë kam shumë për të thënë, por dy të fundit dua të citoj: sarkazmen dhe gjeografinë e vargut të autorit.

Sarkazma në poezi nuk është e lehtë për ta përdorur, madje as në biseda nuk e përdor dot gjithkush. Prandaj autori, z. Ramush, duke përdorur këtë sarkazmë për të godit fenomene apo dukuri shoqërore, tregon formimin e lartë të tij profesional dhe artistik.

Në fund, dua të theksoj se, poezia e z. Ramush, i kalon kufijtë lokal të Pejës, në cilësi, por edhe në hapësira. Ai shkruan për Shkodrën, për Migjenin, për Rozafën, për Tropojën, Valbonën, Pukën e Malësinë e Madhe. Ato vende, që dikur i kishte ëndërr me i pa, kur i ka vizitua, ka lënë një autograf me poezi.

Prandaj edhe ardhja në Shkodër për të promovuar tre vëllimet e tij, është ëndërr, është festë dhe është triumf...

Suksese miku dhe kolegu ynë Ramush Nikçi!

Nga sot librat e tu janë në bibliotekën "Marin Barleti" të qytetit tonë, janë në

dorën e lexuesit, në dorën e miqve të tu nga Shkodra dhe Shqipëria.

Nga sot puna jote krijuese është pronë dhe vlerë e shoqërisë!

Jetë të gjatë dhe Sukses!

**Poetja Bona Mulaj-Lluka**

Përhëndetje të gjithëve!

Mire se keni ardhur në këtë promovim,



të zakonshëm si zhvillim, por të veçante për nga emocionet që përcjell gjithmonë ardhja e vëllezërve e motrave nga trojet e tjera shqiptare, që dikur e kanë pasur ëndërr, për të ndare me ne vargjet e tyre, ndjesitë e tyre, shpirtin e tyre.

Sot, ato na vijnë ngarkuar me bukuritë e bjeshkëve të Dukagjinit, me krenarinë e kreshtave të Rugovës, me butësinë e shpirtit të një poeti, me hijeshinë e vashës, na vijnë ngarkuar me boren e Alpeve, me rrjedhën e kristaltes të Drinit,... na vijnë me agun e mëngjesit të Pejës sonë të bukur.

është promovimi i artisteve të rinj të muzikës tradicionale, të cilët janë gjithmonë të lumtur dhe krenare të përfaqësojnë Dukagjinin, por edhe krahinën, prej së cilës vijnë, promovimi i bëhet gjithashtu edhe nga ana e bashkëprezantueses së re, Pameles, e cila dëshiron të hyjë në këtë fushë, ndërsa Klodjana tashmë nga shumica personifikohet edhe si prezantuesja e Sofrës së Dukagjinit.

shfaqjes. te cilët çdo vit janë bujare për tu siguruar që shfaqjes të mos i mungojë asgjë, meritojnë mirënjohje të madhe si nga diaspora por edhe bizneset vendase.

Sfida më e madhe çdo vit është edhe arsyeja, pse bëhet kjo shfaqje Publike?! Atij publiku, që e adhuron sofrën, atij publiku që fillon e pyet, që në Gusht, nëse ka sofrë këtë vit, të atij publiku që vjen posaçërisht nga diaspora për sofrën e Dukagjinit, të



Sofra gjithashtu përfshin edhe fëmijët si ajkën e shfaqjes, në të cilën me vallet e tyre kërcëjnë si flutura në skenë, energjia e tyre ka shoqëruar çdo këngë dhe çdo valle në atë skenë.

Por, sofra nuk harron kurrë edhe miqtë artiste nga Kosova, të cilët gjithmonë na mirëpresin kur i vizitojmë familjet e tyre si të jemi në shtëpinë tonë.

Elemente thelbësor gjatë shfaqjes janë falënderimet për mundësitë financiar, që bëjnë të mundur përgatitjen e realizimin e

atij publiku që dëshiron që tradita të përcillet e të atij publiku që kontribuon, që sofra të transmetohet.

Prandaj mund të themi se 'Sofra e Dukagjinit', i bën nder Dukagjinit, me prezencën e saj, ka emrin e madh, dhe duhet të jetë gjithmonë e pranishme, në ditët dhe festat e të gjithë Dukagjinave kudo që ndodhen, por edhe të gjithë Shqiptarëve

**Klodjana Serraj, janar 2023**

Tek po lexoja vargjet e Ramushit, nuk kishte si mos të më mbërthente një ndjesi krenarie e të qenit malësore.

Vargje, që përbalnin realitetin në tere dimensionet, të prekshme e të paprekshme, por kudo njeriu mbështjellë në dinjitetin e tij.

Diçka, që bie në sy tek lexon poezi pas poezie janë përshkrimet e vendeve ku Ramushi kalon, analizën në vargje që u bënë bukurive të natyrës e të njerëzve, duke pasur njohuri dhe për figurat e objektet që karakterizojnë atë vend ku ai kalon apo pushon.

Vetëm një njeri, që e shih të bukuren ngado mundet ti thure vargje pishave të Pukës, syrit të tropojanës, peshës së Rozafës, vashës së Rugovës e të tjera, duke përjetuar në vargje çastet e jetës, si një ditar i veshur me lule, që kushdo e lexon krijon në mendje destinacione për ti vizituar një ditë.

Mu kujtua "Eja dallëndyshe" kur mu tha, që në Shkodër, për promovim do vije një autor nga Peja... ishte rasti i dyte, që ftoheshja të flisja dy fjale, për vargjet poetëve që vinin nga Kosova jonë.

Mbushur krahët me mall, vinin të zbarkonin në gjë të nenës, për ti thënë, ja bijtë e tu nana Loke... jeta i ka lodhur, por nuk ua ka prishur shpirtin për të shkruar, as zbehur dëshirën për ti përcjelle bashke.

Dua ta mbyll fjalën time, e përcjelle dëshirën madhe të autorit për të qenë sot këtu me ne, me vargjet e poezisë së tij:

## BUZËQESHJE SHKODRANE

*Ende pa zbardhë dita m' erdhi një mendim  
Si ta kaloj majën me një vit mundim  
Të dal përtej gardhit me oreks të vjetër  
Të shoh trëndafilin në lëndinën tjetër  
A lulëzon njësoj si n' livadhin tim?  
Do të nisëm bjeshkëve assesi n' makinë,  
Ta shoh se si dukët Shkodra në agim.  
T'i mësoj përmendësh poezitë e Mjedës  
Tablo e atëhershme si në kohë t' mesjetës.  
Dallëndyshe eja, përhëndet Shiroka!  
Trup për male t' blerta, ëmbël buzëqesh toka.  
Trupoj ndër lugina ta shkurtoj terrenin,  
në kasolle të errët ta takoj Migjenin.  
Me guxim luani larg frikës së hiçit,  
t' i lexoj me shije prozat e Koliqit.  
Ndoshta Gurakuqi me mustaqe t' zeza,  
më jep zemër shkambi, mrekulli ndër breza!  
Dru që po harrova mund të më vrasë buka  
Pa marr guxim zjarri n' kullë të Oso Kuka!  
Shpejt kaloj pa leje në qytet te daja  
Me zemër të hapur me mirëpret kështjella!  
Kondicion fatosi, mendjen Abetare  
Ta takoj n' muroja Rozafën bestare!  
Rrugës shtruar n' gurë ngjitem përballë qiellit  
Syri plot uri sot nuk ja varë diellit  
Këtu shoh paraqsën e botës reale  
Lumë, liqë e det, rreth bjeshkë e livadhe.*

*Ç' është kjo perlë antike, nusëri legjendash  
Vargon i pasosur, vatër trima pendash  
Për pushkë nuk po flasim, tregon historia  
Prapë bjeshkëve, si bisha, unë kthehem te shpia  
Me fli autokton, më mirëpret Malësia  
Tung qytet hero, t' bekoftë Perëndia!*

# XHUBLETA E NGUSHTË E DUKAGJINIT TIPOLOGJI E VEÇANTE NE HARTEN ETNOGRAFIKE SHQIPTARE

Një vështrim i përgjithshëm mbi veçoritë dhe vlerat e xhubletës së ngushtë të Dukagjinit e njohur më herët si xhupeta e lehtë e veriut

Në përshkrimet e përgjithshme shkencore xhubleta e ngushtë Dukagjinit, është përmendur në mënyrë pothuajse empirike nga studiuesit vendas dhe të huaj pasi ajo përbën një sfidë më vete për faktin se gjendet shumë pak ose aspak në përdorim, gjë që e bën akoma më të vështirë deshifrimin e vlerave dhe veçorive të saj. Në të vërtetë kjo është edhe arsyeja kryesore që ka çuar në spostimin e vëmendjes së vëzhguesve bashkëkohor vetëm tek ato, që vishen dhe ekspozohen akoma edhe sot, çka ka ba që xhubleta për opinionin publik të unifikohet dhe identifikohet vetëm në lokalitete të vogla si p. r. sh. Kelmendi nëpërmjet të cilit nënkuptohet edhe xhubleta, duke anashkalua hartën etnologjike si dhe tipologjitë e tjera të xhubletës dhe rëndësinë e tyre në rrafshin etnokulturor.

- Po cilat janë disa nga veçoritë që mbart xhubleta e ngushtë në lëmin kulturor shpirtëror dhe pse duhet të kthehet në vëmendje kjo tipologji xhublete?

- Xhubleta e ngushtë e Dukagjinit ose Xhubleta e lehtë e malësive të Gjakovës dhe Dukagjinit emërtim i cili në t' folmen e malësoreve të vjetra vazhdon të thirret edhe sot me këtë emër, si një mënyrë specifike për ta ba të dallueshme në mesin e tipologjive të tjera, vjen në dy o më shumë forma dhe nëntipologji të ndryshme, duke u përshkallëzuar edhe në elementet identifikues të huazuar nga kulturat në kontakt. Në këtë tipologji xhublete gërshetohen elementet kulturore të origjinës së vajzës, ku kishte lindur me atë të burrit, me të cilin do martohet, duke i përshtatur këto tipare në veshjen e saj. Ky fakt vihet re tek vajzat me origjinë nga Mirdita, të cilat për tu identifikuar, por edhe përshtatur me kulturën pritëse, kanë ruajtur disa elemente të rëndësishme kulturore tek shtati i xhubletës. Mbi sfondin e bardhe të xhokës mirditore kanë qepur dhe shtuar shirita të zinj vertikal, me shkrola zbukurimi këndore të zeza me mbushje spiku ose fije të dredhur konop. Mbi këtë xhokë ose shtat të xhubletës kanë shtuar bohçen, jelekun, brezin e në disa raste edhe kapiçën. Këto elemente i shohim shpesh

tek disa xhubleta nëpër fotot arkiv që qarkullojnë në rrjetet sociale, sidomos tek ato të pozuarat në profil. Po kështu edhe xhubletat periferike të Dukagjinit apo të malësive të Gjakovës sikurse ajo që njihet si xhubleta e Pukës në kontakt me kulturat ndërkufitare, tipologjisë së xhubletës së vjetër të Komanit, e zeze mbi të zeze në trajtë kambane, i kanë shtuar elementet e paranikut dhe prapanikut të mbivendosura te kjo xhubletë, në të cilën kanë përfshi edhe disa ndryshime në formën dhe ngjyrat e shtatit të saj, duke i unifikuar një stilim të veçantë nga koka te këmbët në të njëjtën linjë qëndrueshme, të gërshetuar mes vertikales dhe horizontales. Këtu tek kjo xhubletë si askund tjetër në këtë trevë do të gjejmë elemente dallues që lidhen me shkrolat, ku jo pak nga ato kanë lidhje dhe shpjegime konkrete me të ashtuquajturën terminologji shkencore "KULTURA E KOMANIT". Ndërsa xhubleta, e cila bie në kontakt me xhubletën e Malësisë së Madhe. Pra, në kufirin verior të kësaj treve ka më shumë ngjashmëri me këtë tipologji deri edhe tek përmasat dhe elementet përbërëse të saj.

- Një tjetër element, që e bën ende më të veçantë xhubletën e ngushtë është prezenca e jeleku me thekë të dendur e të rënduar, që bien nën supe, i cili i jep gruas nën petkun e saj një lloj potenciali juridik ndër fisnor, gjë që xhubleta e Malësisë së Madhe nuk e ka dhe nuk e pranon këtë element në përbërjen e saj. Ky element kulturor i shtrirë në një habitat të gjerë ndër fisnor, të cilin studiuesit sot e ndajnë me rrethe si xhubleta e Pukës, Tropojës apo e Dukagjinit është një përbërës shumë i rëndësishëm për deshifrimin e lidhjeve të ndërmjetme gjenetike të maleve të Dukagjinit dhe mbart pothuajse të njëjtën peshë sikurse Kanuni në përcaktimin e identitetit të këtyre nen fiseve.

- Element tjetër në këtë gërshetim vlerash është edhe grykollja e xhubletës së Dukagjinit, e cila në paraqitjen e saj në profil ka një lloj kodi të trokuar nga i cili përcaktohen elementet bartëse të saj. Nëse kjo grykollja i përket një xhublete të ngushtë me sfond të bardhë atëherë në të

kemi gërshetim të këtyre dy ngjyrave duke ruajtur stilin vertikal të punimit të saj, dhe nëse ajo i përket një xhublete të zeze në formë kambane mbart një stilim me grykë të rrumbullakët, ku edhe qëndrueshmëria dhe shkrolat e saj ndjekin të njëjtën linjë. Në disa raste këtë grykollja e kemi të zbukuruar me lule sermi tipike të xhubletës.

- Po kaq e veçantë është edhe bohçja apo pëshqjellaku i xhubletës së ngushtë për nga stilimi me punime të zgjatura vertikale, simetrike të cilat përthyhen bukur mbi shiritat horizontal, për të mbajtur statike të hapur fundin e saj në formë trapezi në disa raste të rrethuar me thekë të dendur të njëtrajtshëm sikurse jeleku apo kraholi i saj, elemente këto që bëjnë kontrast dhe e hijeshojnë së tepërmi këtë petk.

- Në këtë tipologji xhublete do të veçoja rëndësinë dhe peshën kulturore të brezit të xhubletës së ngushtë si një nga elementët më unik ndër të gjitha tipologjitë e xhubletës por edhe të të gjitha veshjeve tradicionale shqiptare.

BREZI - një rrip i ngushtë lëkure i veshur me lule sermi ose pllaka argjendi në të cilin vareshin katër palë rrathë me nga tre të tillë secila të bashkuar në mes si një gonxhe luleje në të çelur të saj.

Tek brezi i kësaj xhublete vihen re disa elemente tejet të rëndësishëm te besimi pagan, i cili lidhen me kultin e diellit dhe të hënës. Tek ky brez pasqyrohet dielli si element zbukurimi në pjesën ballore të tij mbi pllakat prej argjendi, por edhe mbi trekëndëshat ku bashkohen rrathët çka nënkuptojnë muajt hënor stinor. Siç e shpjeguam tek brezi i xhubletës së ngushtë në mënyrë simetrike kemi të varur vertikal katër palë rrathë të barabartë, ku secili ka të kapur në një pikë bashkimi nga tre të tillë, me një fytyrë dielli, gjë që për bartësit e kësaj veshje merr kuptim dhe shpjegim stinor, ku secila stinë ka në harkun e saj kohor tri hënë.

Këta rrathë si elemente zbukurimi kanë disa vargje metalike kryesisht të argjendta, të cilët kryqëzohen mbi njëri-tjetrin e që nënkuptojnë pastërtinë e gruas, mbrojtjen e saj nga forcat e errëta të natyrës dhe vijimësinë e jetës së gruas në kohë e në hapësirë. Gratë në moshë, për brez mbanin një rrip më të gjerë tirkur, në të cilin shpesh shohim se ka të qëndisur me terstil simbolin e jetës, në mënyrë horizontale rreth brezit, ku në fund ky brez merrte formën e kokës së gjarprit në bash-

kim, ku vendoseshin edhe kamçarët. Në raste të rralla kur brezi ishte më i gjerë bëhej me dy kokë, në mënyrë që shtati i gruas të ishte edhe më i ngjeshur.

- Veçori tjetër e xhubletës së ngushtë është masa dhe peshja e saj më e vogël në krahasim me xhubletën e Malësisë së Madhe, e cila i mundëson gruas dukagjinase ta ketë më praktike në përshtatje me terrenin ku ajo jetonte. Në nën veshjet e saj kjo xhubletë vjen ende më e thjeshtë, duke marrë formë edhe më praktike, ku xhubleta e punës përmban një shtat të lehtë xhublete me material tirkur dhe me iva të rrallë spiku, pa postavim e pa shkrola, një bohçe të thjeshtë me punim në katër liq dhe një krahol që i mbulonte shpinën dhe para i rrinte i hapur për ti lehtësuar lëvizjen e kraheve, me një palë çorape edhe ata të punuara në katër liq, ose me punim të veçantë me gjipnerë dhe një shami të lidhur nën qafë.

- Luku i gruas që mbarte këtë tipologji xhublete ndryshonte tërësisht me malësoret e Malësisë së Madhe. Gruaja dukagjinase dallonte edhe nga kjo veçori pasi ajo mbante rreth ballit të saj një palë flokë të valëzuar ku i theksoheshin vetullat dhe i jepej liri t' pamit.

- Stolitë e xhubletës së ngushtë veç brezit mbanin edhe vierrcat e supeve me boçë e me thekë, që simbolizojnë litat, frytet e Lises së Shenjtë. Gjithashtu kishin edhe groshatar të ndryshëm ku binte në sy ai me një tipike e malësoreve katolike në moshë.

Këto ishin disa nga veçoritë e xhubletës së ngushtë të Dukagjinit, të cilat na vënë para përgjegjësinë të gjithëve.

Kthimi i saj në përdorim pasuron jo vetëm kulturën shpirtërore e tradicionale të trevës së Dukagjinit, por do ta ringjallte dhe shpëtonte nga asimilimi i plotë kulturor, këtë pasuri tejet të rrallë kombëtare, gjithashtu do të mbushte atë boshllëk kulturor të krijuar në dekadat e fundit nga spostimi i vazhdueshëm apo mos vëmendja e trashëgimtarëve të saj, për ta ruajtur dhe kultivuar ndër breza këtë pasaportë të veshur me identitet kulturor.

Ky petk i mishëruar me kulturë shpirtërore ka edhe një gjuhë të koduar, të cilën mund ta deshifrojë dhe përkthejë me t' folmen e saj vetëm malësorja që e mbart dhe trashëgon këtë veshje në genin e saj gjenetik.

Në trungun ku xhubleta e ngushtë e Dukagjinit pati edhe plotësinë e saj në kohë e në hapësirë që nga lashtësia e deri më sot.

Shkruar nga Rita Shkurtaç,  
Janar - 2023





# 75 VJETORI I ANSAMBLIT FOLKLORIK AUTOKTON "RUGOVA"

Me datën 23 Dhjetor 2022, në Restorantin "Universi", në Pejë u shënuar në menyrë solemne 75 vjetori i Ansambllit Folklorik Autokton (AFA) "Rugova", njëri ndër ansamblet më të suksesshme që ushtron veprimtarinë e vet në trojet shqiptare.

AFA "Rugova" veprimtarinë e filloi në vitin 1947 dhe që nga ajo kohë sukseset nuk i munguan si në koncerte dhe manifestime të ndryshme në nivelin kombëtar ashtu edhe në skenën ndërkombëtare. Kremtimi i këtij përvjetori filloi me intonimin e hymnit kombëtar, për të vijuar më kumtesa, që shpalosnin historikun e këtij ansambli, i cili ruajti dhe kultivoi më shumë suksesin kulturor, doket, traditat dhe etimologjin e Treves së Rugovës.

Manifestimi filloi punën me përrimin e dy librave për AFA "Rugova", ruajtëse e trashëgimisë, e dokeve dhe e traditave të kësaj ane: Visare të trashëgimisë shpirtërore të Pejës me rrethinë II, AFA "Rugova" – thesar i trashëgimisë kulturore shqiptare, Pejë, 2019 dhe Lojërat Tradicionale të Rugovës, Treveza pejane si vlerë autentike, Pleqnia në odat e anës së epërme të Dukagjinit.

Drejtori i AFA "Rugova", z. Vesel Nikçi



në fjalën e vet përshëndetëse, në mes të tjerave theksoi: "Ju deshiroj mirëardhje ansambleve dhe shoqatave të ftuara, për këtë përvjetor dhe njëherit i falenderoj të gjithë anëtarët dhe familjarët e tyre, që më vite kontribuan dhe shpalosën vlerat e autoktonisë së treves së Rugovës".

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të AFA "Rugova": Të nderuar anëtar të AFA "Rugova", familjar të atyre që për 75 vjet

barten një mision të shenjt, duke përcellë nga brezi në brez gjithë këto vlera të trashëgimisë kulturore kombëtare, prirur për shumë dekada nga prijësi, udhëheqësi, drejtuesi Ramë Kapllan Nikçi, themelues e ideolog, pa të cilin sot nuk do të festonim.

Ju bashëpunor e përkrahës, Ju që më prezencën tuaj madhështuat këtë festë, nga të gjitha trevat shqiptare, prej Vlores deri Shkoder e Tuz, Rozhaj e Preshevë, Shkup e Tetovë, Ulqin e Tiranë, shkencetar, publicist, valletar punonjës të kultures, kengëtar e studiues; Ju nga Rugova, Peja e krejt Kosova.

Falënderojmë nga zemra, juve që na zgjatet jeten, na inkurajohet, na motivohet, na nxitet që të vijojmë tutje në kultivim, begatim dhe prezantim të këtyre vlerave. Porosia e këtij takimi kulturor është: Kërkojmë, që dora e shtetit të zgjatet më përkujdesje, ndihmese, koncertim, ruajtje në mbrojtje, konkurim të Unesko-s, sepse aty e kemi vendin, mos të vonohemi.

Të hapet shkolla për trashëgimi shpirtërore e materiale; të futet në programet shkollorë si

mesim i zgjedhur: Trashëgimia, si lëndë mësimore. Lënda e muzikës ndër shkolla të pasurohet më programe për instrumentet tona. Artizanati i punimit veshjes kombëtare poashtu të nxitet që të ushtrohet ndonse shumë pak kanë mbetur nga ta.

Falënderit për përkrahje: Ministri e Kulturës, Komunë e Pejës, Elkos group, Ujë Rugove, Dardanet Pejë, Elsa Pejë, Lugjet e Verdha Rugovë dhe shumë të tjerë, që po kontribuojnë më mjete materiale e logjistike të AFA "Rugova".

Shpresojmë, që këto pika më lartë, në 80 vjetorin e ardhshëm të takohemi më realizim këtyre propozimeve.

Mirënjohes gjithë juve nga Ansambli Folklorik Autokton "Rugova"!

Në kuadrin e këtij përvjetori shumë ansamble dhe shoqata shpalosën këngë, valle dhe vlerat e folklorit ton burimor nga trojet e ndryshme të atdheut, dhe u ndan shumë mirënjohje e dekorata për anëtarët e AFA "Rugova" dhe për pjesëmarrje të ansambleve e shoqatave që bashkëpunuan me AFA "Rugova". Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" nga Shkodra, e përfaqësuan Kryetari z. Ndue Sanaj, Prel Milani, Gjon Kosteri, Gentian Gropaj e Bledar Hyseni.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" e nderoi më titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", këngëtarin e AFA "Rugova" z. Shaban Demaj, me motivacione: "Shoqata Atdhetare Dukagjini në respekt të bashkëpunimit disavjeçar me Ansambli Autokton "Rugova", vlerëson traditën e ngjashme në art, kulturë dhe histori midis Rugovës dhe Dukagjinit; duke e vlerësuar Shaban Demën, njërin nga më të vjetërit e këtij Ansambli, për kontributin e tij, si valltare, krijues dhe këngëtar i njohur në Rrafshin e Dukagjinit dhe në gjithë trevat shqiptare, në luftë dhe në paqe, është simbol krenarie dhe frymëzimi për ne". me kete rast pershendeti z. Prele Milani, publicist, poeti e historiani dhe N/Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe dorëzoi titullin.

Frasher Racaj e Kumrie Shala



Ukshin Jasharaj nga e majta, Rrahman Lajçi nga Rozhaja, pajtimtar, Ndue Sanaj dhe Arif Husaj nga Rozhaja



Këngëtarët Gentjan Gropa e Bledar Hysaj



Prele Milani, duke dorëzuar titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", për artistin Shaban Demaj



# Na bashkoi kënga-Darka e Dukagjinit, në Nju-Jork

Mbas veprimtarisë së suksesshme të ansambllit folklorik "TREVA" në teatrin "Migjeni", siç është bërë traditë tash disa vjet, disa ditë mbrapa dhe pikërisht me 10 dhjetor 2022 u zhvillua në Nju - Jork "Darka e Dukagjinit", një manifestim i shkëlqyer kulturor e artisti, duke e pasuruar trashëgiminë kulturore e folklorike të Dukagjinit e më gjerë, me krijime të reja e interpretime brilante. Mikpritësit e kësaj veprimtarie artistike kishin ftuar pothuajse të gjithë këngëtarët e ansambllit "Treva", por për arsye procedurash udhëtuan dhe morën pjesë në këtë veprimtaritë vetëm të përherëshmit Ndue Shytani e Fran Kodra si dhe këngëtarët nga Nikaj - Mërturi: Lekë Pecnikaj dhe vëllezërit e Gëzim Nikës dhe këngëtarja Vjola Shqau. Ka disa kohë që në çdo manifestim folklorik, hapja bëhet nga grupi me këngën "Jena dukagjinë e Lekës" shoqëruar nga grupi i valleve, me kostumet kombëtare tradicionale të përgatitur me profesionalizëm nga koreografja e mirënjohur Angjelina Nika. Të gjitha kostumet i kanë sjellë organizatorët nga Shqipëria, të punuara në mënyrë artizanale.

Darka u hap me këngën majëkrahut "Dukagjini Nderi i kombit". Lahuta jonë shqiptare, me në telin e saj u përcoll lavdia e heronjve, historia dhe heroizmi i Dukagjinit dhe Malësisë, zuri vend të veçantë ku këngëtarit i talentuar nga Plani i Dukagjinit, Prelë Marku, i cili i kishte munguar disa kohë në veprimtaritë e folkut dukagjinase, plotësoj dëshirat e të pranishmëve me dy këngë: me çifteli këngën "Lum kush gëzon fatin e parë", shoqëruar nga grupi dhe me lahutë këngë për "Ali Pashën", pjesë e Lahutës së Malësisë të Gjergj Fishtës e interpretuar shumë cilësisht me melodi puro dukagjinase, me një zë melodioz, i cili na kujtoj lahutarët më të mirë që nuk jetojnë më si bashkëvendlindasii tij, Lekë Plaku e të tjerë.

Këta rreshta po i shkruaj në ditët e

para të janarit, mbasi morëm vesh lajmin e kobshëm se Prelë Marku, këngëtar i talentuar me çifteli e lahutë, ka ndërruar jetë në mënyrë të papritur, vdekje e cila pikëlloj pamasë koleg, shokë e miq, duke përfshirë edhe mua si ish mësues i tij. Pushoftë në paqe! Ftohen grupi i burrave në skenë, të cilët kënduan këngën "Darka e Dukagjinit", ku ndër të tjera thuhet: "seç po këndon bilbili / bjeshkës e vrrinit / shtrohet në gurbet /



darka e Dukagjinit".

E ftuar speciale e kësaj darke ishte këngëtarja e talentuar, e mirënjohura Hana Nikprelaj, me origjinë nga Tetajt e Mërturit, e cila u futë në skenë me vargjet: "tash sa vjet e kem dishrue / n' sofrën tonë për me e shikjue / me ja ndie at za kushtrimi / n' darkën tonë të Dukagjinit", e cila interpretoj këngën "Unë e due Shqipërinë".

Këngëtarit nga Nikajt, pjesë e Ansambllit të shtetit, Lekë Pecnikaj këndoj këngën "Çikës së Dukagjinit".

Dy artistët, meteor të folkut burimor, që tash shumë vjet po e mbajnë gjallë dhe po e pasurojnë folkun dukagjinase e më gjerë, me organizimet, krijimet e interpretimet e tyre: Fran Kodra e Ndue Shytani, të cilët u paraqitën në këtë veprimtari me dy këngë:

"Amerikë moj Amerikë" dhe "Interneti", që ndër të tjera theksohet: "Amerikë moj Amerikë / je atdheu i dytë / ban gjithkand me të dashtë/ hallet me i kja bashkë", dhe tjetra: "internet"- na bani për veti / na solli magjinë /na vulli dashninë / e të tjera.

Bija e Mërturit dhe nusja e Shalës, Bukurie Funiçi u paraqit me këngën "Çikë shaljane", që ndër të tjera theksohet: "Çikë shaljane, çikë shaljane / përmjet hollë e shtatvigane / po thonë mriza, kroje e stane

/ je ma e mira e ksaj ane".

Artisti me përmasa kombëtare, me një repertor shumë të pasur, që i qëndron kohës, Gëzim Nika bashkë me vëllezërit e tij: Ndue, Gjon e Pjetër Nika, interpretuan këngët: "Bjeshkët e Shalës" dhe "Kosovë trimja po çon fjalë". Aty theksohet: "Bjeshkët e Shalës lidhin jezerin / Mehmet Shpëndi rrokë manxerrin /...", ose "Kosovë trimja po çon fjalë / kush ma qet zanin në Shalë /...".

I përherëshmi në veprimtarinë e folkut, në Shqipëri e Amerikë, këngëtarit i mirënjohur dhe shumë i pëlqyer, këngët e të cilët janë bërë hite, thethjani me banim në Amerikë, Nikë Çarku, u paraqit me dy këngë: "Për Gjergj Kastriotin" dhe "Dalë nga dalë po vjen pleqnia".

Këngëtarja nga Mërturi, me banim në

Miçigan u paraqit me këngën "Malli për vendlindjen" si dhe formuan një trijo me F. Kodrën dhe Nd. Shytanin me këngën "O marak".

Viola Shqau këndoj një këngë për xhubletën shqiptare.

Moderator të darkës ishin Nikë Çarku dhe Xhulia Lpeja, kjo e fundit nga një familje e nderuar e Gimajve të Shalës, vajza e Gjokë Martin Lpejës. Këta u treguan profesionist të vërtetë, duke mos i marrë kohë programit, siç ndodh shpesh në veprimtari të tilla.

Kjo veprimtari kaq madhështore, me shumë shpenzime nuk mund të bëhej pa kontributin e shumë dukagjinase me banim në Amerikë, duke përfshirë darkën, udhëtimet dhe akomodimet e shumë këngëtarëve ardhur nga Shqipëria, blerjen e shumë kostumeve kombëtare dhe shpenzime të tjera. Këtu duhen veçuar dy mikpritësit dhe organizatorët kryesor: Kujtim Funiçi nga Gimajt e Shalës dhe Ndoc Suka nga Gjurajt e Pultit, të dy me banim e pune në Nju- Jork.

Kishte edhe kontributor të tjerë si: Dedë Prëndaj, Ndreke Tonaj, Lin Kumbulla, Tonin Mbrapshtia, Anton Raja, Pal Kapaj e të tjerë. Që të kemi një panoramë të plotë për zhvillimin e kësaj veprimtarie na e mundësoj z Gëzim Brahusa, dashamirës i folklorit, sidomos atij dukagjinase, i cili na e transmetoj në televizionin e tij prestigjioz muzikor TV Blu-Skaj, në netët e vitit të Ri. Ai vetë e kishte filmuar nga afër në Nju - Jork, në natën e 10 dhjetorit.

Kjo darkë ishte një manifestim i madh kulturor e artisti, që e pasuroj trashëgiminë kulturore e folklorike të Dukagjinit e më gjerë, me krijime e interpretime të reja dhe ishte një apel që këtë trashëgimi të pasur artistike dhe etnografike ta përcjellin te brezat e rij brenda e jashtë tokës nënë, sepse folklori e tradita janë kauza etnike si gjuha e gjaku jone shqiptar.

Urojmë që organizatorët dhe këngëtarët e kësaj darke mbresëlënëse të na organizojnë veprimtari akoma më cilësore në të ardhmen.

**PRELE SHYTANI,**  
Shkodër, Janar 2023



# ARTILERIA NË FORCAT E ARMATOSUNA TE SHQIPËRISE, NË 102 VJETORIN E KRIJIMIT TE SAJ



**Kolonel (p)  
FLAMUR  
MUÇA**

Shpallja e Pavarësisë, me 28 nëntor 1912 e krijimi i shtetit shqiptarë pas gati 5 shekuj robërie nga pushtuesit otomane, është akti më madhor që rilindësit tanë të prirë nga Ismail Qemali, që realizuan në një kohë tepër të vështirë për gadishullin Ballkanik, i cili ishte përfshirë nga lufta e pare ballkanike dhe shqiptarët ishin në gjendje të rëndë, se kishte renë perandoria otomane, rrezikonin ekzistencën e tyre nga oreksi i shteteve fqinj për pushtimin e copëtimit të saj.

Një nga përparësitë e qeverisë të dale nga kuvendi i Vlorës, për kushtet aktuale ishte krijimi i ushtrisë, e cila u vendos në mbledhjen e 4 dhjetorit 1912, me emërimin e Gjeneral Mehmet Derralla, në postin e ministrit të mbrojtjes.

Me 4 maj 1913 u njoftua krijimi i Shtabit Madhor i ushtrisë shqiptare me kryetar Major Ali Shefqeti. Koha e veprimtarisë e qeverisë të I. Qemalit që e shkurtër, pasi për rrethanat e krijuara u detyrua të japë dorëheqjen. Vendi, në vazhdim do të drejtohej nga princ Vidi, i caktuar nga kancelaritë kryesore evropiane, por koha që udhëhoqi, që shumë e shkurtër se, me fillimin e luftës së pare botërore, ai largohet nga kish ardhur dhe vendi do të behet arene e pushtimit nga ushtritë ndërluftuese. Kjo situatë do vazhdoje edhe pas mbarimit të luftës, por deri në vitin 1920, Shqipëria do të drejtohej nga qeveri të përkohshme dhe komandat e trupave pushtuese fituese të luftës.

Kongresi i Lushnjës i mbledhur me 21-31 janar 1920 mori vendime shumë të rëndësishme si rikonfirmoi me një akt kushtetues Pavarësinë e plotë të Shqipërisë, zgjodhi Këshillin e Lartë prej 4 vetesh dhe Këshillin Kombëtar me 37 veta, Kryeministër u zgjodh Sulejman Delvina. Votoi unanimisht rrëzimin e qeverisë së Durrësit dhe caktoi kryeqytet Tiranën e të tjera.

Në qeverinë e dale nga Kongresi i Lushnjës nuk përfshihej Ministria e Luftës, por shpejt lindi nevoja e krijimit të saj dhe të ushtrisë shqiptare.

Në mbledhjen e Senatit të datës 30 tetor 1920, u lexua një letër e Kryeministrit, që mban datën 26 tetor 1920, nëpërmjet së shpallte pëlqimin për "formimin të një Ministrie të Luftës". Po atë ditë, u lexua dhe një letër e senatorit, patriotit e poetit shkodran Hil Mosi, që ndërmjet të tjerave shtronte nevojën e krijimit të ush-

trisë shqiptare dhe të Ministrisë së Luftës, sepse "ushtria është ajo fuqi, që siguron gjallërinë e shtetit".

Edhe gazeta "Besa Shqiptare" që botohej në Shkodër, në një artikull të datës 10 Qershor 1920, shkruente, se "Për me perba Shqypnine me e majte duhet një Qeveri, duhet një xhandarmeri, duhet Ushtri". Me krijimin e Ministrisë të Luftës, ministër u emërua Ali Riza Kolonja, Kryetari i Shtatmadhorisë u caktua major Ali Shefqeti (Shkupi). Ushtria shqiptare u organizua mbi bazën e tre regjimenteve ushtarake. Me 5 Dhjetor 1920 u emëruan komandantët e regjimenteve dhe u caktuan vendislokimet e tyre dhe të batalioneve që kishin në përbërje.

Me fillimin e funksionimit të regjimenteve, në muajin janar 1921, ato u kompletuan dhe me 1-2 bateri artilerie, prandaj data **17 Janar 1921**, me vendim të posaçëm është caktuar data e artillerisë të ushtrisë Shqiptare.

Rrugëtimi i saj, në një ushtri e re të sapoformuar e një vendi të varfër me financa e buxhete të kufizuar ka qenë i vështirë, me përpjekje e sakrificat të mëdha, për t'i kaluar si për personelin, i cili vinte nga shërbimi në ushtritë e huaja, ashtu dhe pajisjet që ishin ato të ushtrive pushtuese të mbetura me largimin e tyre. Në varësi të situatave politike, situatave në rajon e marrëdhëniet me fqinjët si dhe të gjendjes ekonomike-financiare do të ecte dhe gjendja në ushtri.



Efektivi i batalionit të Artilerisë tokësore, në Berdicë, 12 mars 1997

Me largimin e qeverisë të Fan Nolit, në vitin 1925, Shqipëria shpallet Republikë me president A. Zogu dhe me 1 shtator 1928 me miratimin e statutit të ri zë fill monarkia shqiptare, me Ahmet Zogun mbret, që tregonte një stabilitet politik më të qëndrueshëm.

Ushtria si fillim do të riorganizohet në vitin 1925, ku do të përfshihej edhe artilleria. Në organiken e saj do të përfshiheshin edhe 4 oficerë italiane, të cilët erdhën si instruktorë për bateritë e artillerisë, që ishin blere në Itali. Në muajin nëntor të

vitit 1929 u dekretua "Ligji mbi organizimin e fuqive armate". Artileria përfshihej në "Forcat Tokësore", me emërtim "arma e artillerisë", ku renditeshin: 1 komandë artilerie; 4 komanda grupi artilerie, me nga 3 bateri secili, artillerinë e regjimenteve. Gjendja organike me oficerë ishte 5 nënkolonelë, 6 majorë, 44 kapitenë të klasisit të parë e të dytë, 27 togerë, 39 nëntogerë, gjithsejta 121 oficerë. Rregullime u benë edhe në vitin 1931 dhe në vijim, ku parashikohej rritja e numrit të oficerëve deri në 200 vete si dhe futja në përdorim e artillerisë me tërheqje mekanike e përmasisime të tjera organizative.

Një nga problemet kryesore, është përballuar me ngritjen e artillerisë ka qenë përgatitja e kualifikimi i personelit të saj. Faktikisht, që përpara ngritjes së ushtrisë shqiptare, në vitet 1920 kishte oficerë shqiptarë të diplomuar në shkollat e artillerisë jashtë vendit.

Në vitin 1926, për nevoja të artillerisë u hap një kurs 1 vjeçar, i cili përfundoi në muajin Janar 1927, në të cilin u përgatiten 6 aspirantë artiljerë. Me ngritjen e ushtrisë, po vinte në shtim numri i trupës së artillerisë, e cila po organizohej në formacione më të mëdha se bateria, grup artilerie, kushtëzoi hapjen në Tiranë të shkollës për aspirantë me profil artillerinë me 20 studente. Këta vinin nga maturat e gjimnazëve, ose të shkollës teknike.

Me 15 Tetor 1928 u përrurua shkolla e artillerisë. Krahas kësaj përparësie, ju dha

rinjtë me diplomë të shkollës së mesme (kjo vazhdoi edhe pas bashkimit të ushtrive me pushtimin fashist të vendit). Edhe për përgatitjen e nënoficerëve e të trupës së artillerisë ekzistonte shkolla e qendra të veçanta. Për trupën funksiononin qendrat e instruksionit të artillerisë në Shkodër dhe Elbasan. Për të plotësuar nevojat për literature, në Shtabin Madhor u krijuar dega e përkthimeve. Në këtë dege ka punuar si përkthyes për artillerinë muzikanti e këngëtarë popullor i përmendur shkodran Kole Gurashi. Duke pasur parasysh vështirësitë që kishte përgatitja e ushtarëve të artillerisë shërbimi ushtarak aktiv nga 6 muaj u ba 12 muaj; ndërsa më vonë u zgjat në 18 e deri në 24 muaj. Për të përcaktuar nivelin e shkallës së përgatitjes e të gatishmërisë së artillerisë, që në vitin 1925 u fut inspektimi i trupave të artillerisë, në Tiranë.

Në strukturën organizative artilleria ka ardhur duke u perfeksionuar. Në fillim ajo është në regjiment (grup), ndera më vonë lindi nevoja për përfshirjen e saj në batalionin e këmbësorie. Me rritjen e buxhetit për Forcat e Armatosura u mundësua blerja e amëve të artillerisë dhe formimin e grupit të artillerisë, dhe në strukturën e shtabeve vendoset oficeri për artillerinë.

Në vitin 1930, në shtabin e regjimentit u shute komandanti i artillerisë. Arritje e madhe është krijimi i Komandës së Artilerisë Tokësore, që ishte në vartësi të Komandantit të Përgjithshëm të F A, që krijoi mundësi më të mëdha, për rritjen e fuqizimin e artillerisë, përgatitjen e personelit, përdorimin luftarak e të zjarrit të artillerisë me efikasitet, në interes të repartëve të këmbësorisë. Krijimi i komandës në nivel regjimenti dhe shtabit madhor jepte mundësinë e përdorimit të artillerisë e zjarrit të saj në mënyrë të centralizuar. Oficeret artiljerë dhe arma e artillerisë fituan një reputacion në masën e personelit ushtarak shqiptar të kohës. Faik Kuku (kolonel i ushtrisë të asaj kohe) thotë, që oficeret e artillerisë përmbajtshin pjesën ma intelektuale të ushtrisë. Këta sollën në Shqipëri kulture e sjellje perëndimore të kohës.

Me gjithë punën e bere për vite të tana, për ngritjen e armës së artillerisë, kur nevoja për mbrojtjen e vendit nga agresioni fashist italian i 7 Prill 1939, ata dhe forcat e tjera të ushtrisë nuk qenë në gjendje të plotësonin detyrën ndaj Atdheut, jo për paaftësi a mosdashje, por për shkaqe politike të brendshme e kapitullues të lidhshimit, që nga mbreti Zog e qeveritaret e tij, të cilët braktisen vendin në atë moment dhe sabotimet që kishte bërë misioni italian pranë ushtrisë shqiptare, në të gjithë nivelet e saj.

Mul Delia, në librin e tij "Besëlidhja e Malësisë" shkruan se: "... një natë para sulmit të Forcave Ushtarake Fashiste italiane, atë e emërojnë komandant të batalionit

“Deja”, që ishte caktuar në pozicionin e dytë të mbrojtjes, në Shijak. Bateria 65/17 mm ishte e vendosur në pjerrësit e rrugës të Shijakut nga perëndimi, në anën e majte të rrugës së Durrësit (kuota 105). Bateria kishte 25 predha dhe këto pa kapsolla. Një shembull për të nxjerre konkluzionin, se deri ku kishte shkuar sabotimi i mbrojtjes derisa në front armët ishin pa municione”.

Me pushtimin fashist të vendit u bë dhe bashkimi i ushtrive të të dy vendeve. Në muajin Qershor-Korrik 1940 u futën në këto forca 4 bateri artilerie 75/13 mm të kompletuara dhe në gatishmëri.

Në muajin Qershor 1939 u hartua lista e oficerëve shqiptarë e korrektuar nga shënime të shkurtër për secilin nga ata, si dhe e realtuar prej komisionit ushtarak italian në Tiranë, i cili i njihte mire ata. Kjo liste, ndonëse jo komplet, mungonin 72 oficerë, pothuajse që të gjithë artiljerë. Kuptohet, që mos përfshirja e tyre në ushtrinë italiane bëhej nga implikimi i tyre në lëvizjet politike të kohës si dhe qëndrimin e tyre atdhetar ndaj pushtimit fashist të Shqipërisë. Qëndrimi i atdhetar i disa oficerëve shqiptar shfaqet dhe në Itali, ku ato vazhdonin studimet.

Disa oficerë shqiptarë u inkuadruan në reparte italiane të dislokuara në Itali dhe mbeten atje. Ndërmjet atyre, që mbeten në Itali, që dhe majori i artilerisë Llazar Bojaxhiu, vëllai “Nene Tereza”.

Në muajin Qershor- Korrik 1940 u bë inkuadrimi dhe njësite e përcaktuara të këtyre baterive të kompletuara e në gatishmëri. Si batalionet shqiptare dhe 4 bateritë e artilerisë në njësite italiane morën pjesë në luftën italo- greke në vitin 1940-1941. Trupat shqiptare në këto luftime mbajtën një qëndrim jo aktiv, duke dezertuar nga fronti prandaj ata, komanda italiane i tërhoqi në thellësi të vendit.

Me kapitullimin e Italisë fashiste vendi pushtohet nga nazistët gjermanë. U krijua Këshilli i Nalte i Regjencës, i cili me 5 Nëntor 1943 emëroi qeverinë, e cila mori përsipër rikrijimin e ushtrisë shqiptare. Formacioni i organizuar ishte regjimenti. Në regjiment bënte pjesë dhe një bateri shoqërimi 65/17 mm.. Në përbërje të ushtrisë shqiptare ishte përfshirë edhe komanda e artilerisë, por organizimi i plotë nuk u arrit të behësh derisa në prag të çlirimit ajo u shpërbë.

Agresioni fashist e pushtimi i vendit u prit me urrejtje nga populli e me rezistence të armatosur, e cila do të vinte duke u shtuar, duke krijuar formacionet e para të armatosura. Krijimi i frontit Nacionalçlirimtar rriti vullshëm luftën e krahas çetave krijohen batalionet partizane dhe me 10 korrik 1943 krijohet Shtabi Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me komandant Spiro Moisiu e komisar Enver Hoxha.

Lufta vjen duke u zgjeruar dhe krijohej njëra pas tjetrës brigadat partizane, divizionet dhe korparmatat. Në të gjitha këto formacione, me armët e rrëmbyera okupatorit fashiste-nazist krijohen dhe nënrepartet e artilerisë partizane, të cilat bahen mbështetje për luftimet, që u zhvilluan deri në çlirimin e vendit, me 29 nëntor 1944, por dhe më tej, në ndjekjen e nazistëve dhe matanë kufirit shtetëror.

Aksioni simbol i artilerisë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare ishte goditja me top nga kodrat e Saukut të pallatit (sot pallati i



Artileria e Ushtrisë Shqiptare, Numerore të Artilerisë, Top-Obuz-152 mm pas vitit 2000

brigadave), ku do të mblidhej e ashtuquajtura Ansamble Kombëtare. Kjo date është përkujtuar deri në vitin 1992, si date e krijimit të Armës së Artilerisë Tokësore të Ushtrisë Popullore Shqiptare.

Mbas çlirimit të vendit, për ushtrinë shqiptare fillon një epokë e re në organizimin e pajisjen e saj me armatim e padisje bashkëkohore. Një vëmendje të madhe do

pash pa zrapje dhe një kompani mortajash;

Në Brigade Këmbësorie: 2-3 grupe artilerie e mortaja, 1 grup kundërtank, 1 bateri lartësie.

Në Korpus-Divizion Këmbësorie: brigade (regjiment) artilerie ose 2-3 grupe artilerie; grup ose regjiment artilerie kundërtank; në bregdet edhe 1 regjiment



Artileria e Ushtrisë Shqiptare pas vitit 2000

të ketë artileria, e cila do të ketë në përbërjen e saj topat e kalibrit nga 45 – 130 mm, obuze e top-obuze 122- 152 mm, mortaja nga 82 – 160 mm, artileri reaktive 107-130 mm, artileri bregdetare 85-130 mm e të tjera . Numri i përgjithshëm në vitet '80 i grykave të zjarrit të kalibrit të mesëm e të madh shkonte në 4000 gryka zjarri, ndërsa së bashku me kalibrat më të vegjël, shkonte disa fish më shumë. E gjithë kjo artileri ishte në strukturën e 127 Brigadave të Këmbësorisë e të 22 Divizioneve të Këmbësorisë .

Ajo ishte e organizuar në bateri e kompani; në grupe (batalione) artilerie, të cilët përbeheshin nga 2-3 bateri, regjimente me përbërje 3-4 grupe; brigade artilerie me përbërje 5- 6 grupe; regjimenti kundërtank, me përbërje deri 6 bateri të topave kundërtank; regjimente të artilerisë bregdetare, me përbërje 4-6 bateri .

Në strukturën e organizative artileria ishte organizuar:

Në batalion këmbësorie: një bateri to-

Pranë divizioneve funksiononin shkollat e oficerëve rezervist, ku rikualifikimesh një here në 5 vjet dhe këto kurset zgjatni 2 muaj.

Përdorimi luftarak i artilerisë dhe zjarri të saj në luftim u sanksionua në Artin Ushtarak Popullor, në të cilën përcaktohej, se artileria tokësore është fuqia e zjarrit kryesore e forcave tokësore, ajo duhet përqendruar në drejtimet kryesore si në mbrojtje ashtu dhe në mësymje. Zjarri i artilerisë e mortajave së bashku me atë të mitralozave dhe armeve të këmbësorisë i ndërthurur dhe me të gjitha llojet e pengesave xhenerierë përbente bazën e sistemit të zjarrit.

Në mbrojtje, mbrojtja kundërtanke në drejtimet e kalueshme nga tanket e mjetet e tjera të blinduara përbente bazën e ndërtimit të mbrojtjes dhe ishte e organizuar e qëndrueshme, e thelle e aktive. Bazën e mbrojtjes kundërtanke e përbente zjarri i artilerisë dhe mjeteteve kundërtankeve.

Një investim i madh u bë në fortifikimin e artilerisë me pozicione zjarri tip tunel, parafabrikat dhe punime fushore. Përveç pozicioneve kryesore për çdo bateri kishte dhe 1-2 pozicione rezervë. U ndërtuan pikat e drejtimit e vendkomandat si dhe u ba kalbëzimi telefonik në rendimet e luftimit. U realizua shtrirja e rrjetit mbështetës të artilerisë në zonat e veprimt të saj me jo më se një pike për km<sup>2</sup>.

Artileria jone e gateshe si në drejtimet tokësore, bregdetare dhe në zonat e desantimit ishin në gjendje, që për 15-20 minuta të hapte zjarr. Grupet kompletoheshin për 2-3 ore ndërsa brigadat 5-6 ore me kontingjentet rezerviste.

Përgatitja e artilerisë realizohej gjithëvjetorë në të gjitha nivelet e saj dhe aftësitë e saj provoheshin në stërvitje shtabi, komando shtabi, stërvitje me trupa me qitjet luftarake që përbenin shkallen më të lartë të përgatitjes. Në fund të viteve '80 artileria filloi të pajisej me makina llogaritëse të programuara për qitjen e drejtimin e zjarrit sipas kalibrave përkatës; largësimatësi me rreze lazer e të tjera, që përbenin një risi për ne .

Ndryshimet në sistemin politik e ekonomik të vendit u shoqëruan me ndryshime të thella dhe në fushën e sigurisë e mbrojtjes. Reformat e realizuara mbas viteve '90 në Forcat e Armatosura sollën ndryshime të rëndësishme, por artileria nga reforma në reforme erdhi duke u zvogëluar në strukture ashtu dhe në nëmurin e grykave të zjarrit derisa nga viti 2005 ekziston në mënyrë simbolike në nivel batalioni. Anëtarësimi në NATO ka krijuar mundësinë e modernizimit në sisteme artilerie e raketash bash kohorë.

Rrugëtimi mbi një shekullor i artilerisë ka në themel të tij kontributin e brezave të ushtarakeve, të cilët investuan e materializuan krijimin e forcimin e saj , u bane roje e sovranitetit e të paprekshmërisë së Atdheut gjate luftës së ftohte e deri në ditët tona.

të artilerisë bregdetare.

Për drejtimin e artilerish funksiononin këto struktura: në batalion- shefi i artilerisë; në brigade- seksioni i artilerisë; në divizion- dega e artilerisë; në shtabin e përgjithshëm - drejtoria e artilerisë.

Një vëmendje e madhe ju kushtua përgatitjes të kuadrit të artilerisë në shkollat tona ushtarake. Pranë shkollës së bashkuar përgatiteshin oficerë artiljerë të nivelit bateri e deri në grup. Në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm kualifikoheshin për nivelin artilerisë të brigadës së këmbësorie e të divizionit këmbësorisë dhe brigade artilerie. Deri ne vite 1960 një pjesë e kuadrit u shkollua dhe kualifikua në shkollat e akademitë sovjetike e më pas të gjithë nevojat plotësoheshin në vend.

Shkollimi për kuadro rezervist ishte i organizuar në 3 shkolla ushtarake Zall-Herr –Tiranë; Bonavi- Vlorë dhe Vau Dejës - Shkodër, ku studimet zgjatnin 2 vjet e përgatiteshin kuadro për drejtimin toge –bateri (kompani).

# LAMTUMIRË PRELË GJOKA

## Ish Shefi i Ndërlidhjes së Mbrojtjes Kundërajrore për Traktatin e Varshavës

Me datën 15.01 2023 mori rrugën për amshim pas një shtegtimi 94 vjeçare! Prele Gjesh Gjoka një nga oficerët e larte të ushtrisë shqiptare i diplomuar në dy Akademi, nder më të mira ushtarake të BRSS.

Në vitet 1959-1961 ka kryer detyrën e Shefit të Ndërlidhjes të Mbrojtjes Kundërajrore për Traktatin e Varshavës.

I hijeshim si ahet e Bullit të Palajve, oficer i shquar karrierë, i ujdur dhe i veshur më së miri, përtej natyre 1,82 m i gjatë, kavalier i vërtetë, që shquante plot shkëlqim mbi koleget e tij të së njëjtimit specialitet. Fisnikërinë ja mbajti dera, nga më të kulturuarit intelektual të brezit të tij.

U rrit si antifashist, u edukua dhe rrëshinua atdhedashës. U arsimua në vendin e luftëtarëve të pa epur të Bashkimit Sovjetik. i qete fjale pak imponant, larg rrezatimit oksidant të politikës. Nuk u demoralizua as kur mori goditje nen brez nga politika, as nuk u vetëquajt si ylle i rrezuar pas viteve nëntëdhjetë. Punoi gjithë jetën me devocion dhe përkushtim shembullor.

Rriti dhe edukoi një familje të denje. E desh me gjithë zemër Shqipërinë, nuk e mbushi gojën kurrë me nëma as fjale të liga edhe në momentet kur atdheu i terrtisi buzëqeshjen dhe i lëndoi zemrën.

Shoshi e Dukagjini sot humben djalin e tyre petrit, shtatdrejte si kallmi e këmbëlehtë, por edhe nga më të mirët intelektual, që rriten loket tona në shekullin e XX.

Sot u shua ushtarakun sy mprehte dhe zemër zjarr, që i beri nder Shoshit, Dukagjinit dhe Ushtrisë shqiptare.

Pushofsh në amshim Prel Gjoka!

Ta kujtojmë me respekt, se meriton

mirënjohjen më të lartë!

Lamtumire Major Prele Gjoka!

### Një Jetëshkrim i shkurtër:

Prelë Gjoka ka lindur me 3 mars 1928, në fshatin Palaj të krahinës së Shoshit.

Në moshën 12 vjeçare largohet nga vendlindja.



Në moshë shumë të re aktivizohet në LANÇ, në Brigadën e 24 -të Sulmuese dhe pastaj në Brigadën e 23 -të Sulmuese.

Ka qene vetëm 16 vjeç, kur zhvilloi punimet Kongresi Antifashist i "Përmetit". Major Gjoka duke kujtuar këtë ngjarje thotë: "Kam shkua në Përmet së bashku me Mëhill Lulashin, Prelë Mark Lulashin e Pecajve dhe disa shokë të tjerë. Nga grupi ynë lejuan të marrin pjesë vetëm 4 vetë, Mëhill Lulashi ndejti me mua, Prelë Marku mori pjesë. Në Përmet kemi nden-

jtë duke pritur një javë, pastaj i jam bashkëngjitur Brigadës 24-të Sulmuese".<sup>1</sup>

Menjëherë pas çlirimit, regjistrohet në shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", të cilën e përfundoj me rezultate shumë të mira, në vitin 1949.

Në Gusht 1949 fiton të drejtën e studimit në Akademinë e Kievit, në Republikën e Ukrainës, në Degën e Ndërlidhjes. Akademia mbante emrin "Kalenin", që ishte Presidenti i Sovjetit Suprem, dhe që konsiderohej njeriu i dytë në B S. Për Gjokën, i pa harruar ka mbete sidomos udhëtimi i parë në një vaporin "Transilvania". Ky vapor kishte qenë i Carit të Rusisë. Kemi shëtitë Mesdheun, jemi ndalë në Konstancë, nga Konstanca kemi ecur me Tren."<sup>2</sup>

Studimet akademike në BS i ndoqi në dy Akademi 1949-1953 në Kievi për Ndërlidhje, ndërsa nga viti 1953-1955 në Akademinë e Radiolokacionit (Drejtimit të Avionëve) "Uljanus Simbris", vendi i "7 erave", quhej në gjuhën tartaro-mongole.

Prelë Gjoka nga Rusia e largët ruan kujtime më të bukura të stinës më të bukur të jetës. "Ne, studentet shqiptarë në Rusi, kemi qenë më të përkëdhelurit e gjithë studentëve të vendeve të Evropës Lindore. Në atë periudhë mjalti shqiptaro-sovjetike, nuk bëhej fare fjale për as një lloj përcmimi as racizmi. Rusët, kishin respekt për shqiptarët, që ishin çliruar vetë nga Gjermania pa ndihmën e tyre, dhe si popuj nuk kishin trashëguar as një armiqësi historike njeri me tjetrin. Rusët, përcmonin rumunët dhe kishin të drejtë

1 - Sipas kujtimeve të Prelë Gjokës, Major në pension..

2 - Sipas Kujtimeve Prelë Gjokës, Major në pension

pasi kishin ves hajdutërinë, spiunllëkun dhe hipokrizinë". Nuk simpatizonin bullgarët që kishin mbajtur anën e gjermanit si shtet në luftë. Pas Akademisë së Radiolokacionit mori gradën e togerit dhe fillon punë në Regjimentin Autonom të Ndërlidhjes.

Në vitet 1959-1961 ka kryer detyrën e Shefit të Ndërlidhjes së Mbrojtjes Kundërajrore, të Qendrës së Ndërlidhjes për Traktatin e Varshavës.

Në vitin 1962, sipas planit të Temo Sejkos, parashikohej të ulnin desant në Pukë, prandaj Prel Gjoka u emërua Komandant i Brigadës Kundërajrore në Pukë.

Në vitet 1963-1967, Brigada transferohet nga Puka në Mirditë dhe Prela vijon të jetë Komandant i saj.

Pas prishjes së marrëdhënive me BS, shihet me dyshim si kuadër, duke arrite deri aty sa nuk i njihej diploma e dy Akademive Sovjetike.

Në vitet 1967-1969 përfundon studimet në Akademinë Ushtarake të Tiranës.

Në momentin absurd të heqjes së gradave, me 1966 mbanë gradën e Majorit.

Në vitin 1970 vjen në Brigadën, me qendër në Vau Dejës, pas gjithë atyre shtegtimeve të gjata kthehet në Shkodër me detyrën e Shefit të Ndërlidhjes.

Që nga viti 1987 është në pension dhe kalon një jetë aktive pranë familjes së vet në qytetin e Shkodrës.

Prelë Gjoka është një nga akademistët më të mirë shkodranë të shkollës sovjetike të viteve 50-të.

### PRELE MILANI



### GJAKU IM ËSHTË KOSOVA

(Një mall i një mikes sime nga Shqipëria për Kosovën)

Kuvendonin dy mike një natë,  
kishin mall e nostalgji  
për tokat shqiptare  
Kosovë e Shqipëri  
Eh kurbeti është i egër  
edhe ëndrrat ti bën si korbi i zi.

Po lutem moj mikja ime  
çdo natë e malli s' më hiqet,  
Kurbeti i mallkuar na dogji për së gjalli,  
e shpirti uroj mos t' më dali,  
Gjer sa ta shoh edhe njëherë Kosovën,  
se më dogji malli.  
Ta nuhas aromën e saj,  
ti shoh fytyrat e nënave, ti përqafoj,  
e rrudhat në ballë t'ua përkëdhel e fort ti shtrëngoje.

Bashkë me nënëloket me shpirtë të dërmuar,  
ti qaj me lot plagët që s'kanë për t'u harruar.  
Por nderin e krenarinë e mbrojtën  
nuk mundi t'ua shuaj as lufta.

Në kurbet vuajta për ju gjaku im,  
zemra qahej në dysh për vendin tim,  
Po forcë nuk kisha që të vija,  
në luftë që t'ju bashkohem  
për liri të sakrifkohem.

O pasha këtë shpirtë  
Edhe sot kam mall për ty Kosovë,  
E nëse ditët e vdekjes i kam të numëruara,  
të betohem o mikja ime,  
do të doja vetëm edhe njëherë  
ti shikoj anë e kënd ato troje,  
e atëherë le të pushoj e qetë,  
sepse atë vend nga të parët  
e mi i kam amanet.

Mallkuar qofsh  
oj varfëri që na rrëmbeve,  
e aq larg na trete,  
Njëherë na ndau shkau,  
tani po na ndanë kurbeti.

Malli për ty Kosovë nuk do të hiqet kurrë,  
Të premtoj mikja ime,  
se do të vijë e të ulem në gjunjë edhe njëherë,  
e do ta puthi atë tokë e ta laj me lot,  
se erë gjaku ende po i vjen...

Sa shumë kemi vuajtur e po vuajmë edhe sot,  
E shpirti po na dhemb,  
Sa s'mund ta imagjinoj dot.  
Sa kam mall për ju o gjaku im i shtrenjtë,  
se nga të parët e mi ju kam amanet përjetë.

**Kumrije Shala**

\*\*\*

### BESOJ NË DIELLIN

Poezi e një të burgosuri hebre anonim  
(E shkruar në muret e një bodrumi në Kampin e Përqendrimit në Këln të Gjermanisë)  
Strofa e parë e kësaj poeme u gjet e shkruar edhe në Aushvic.

Besoj në Diellin  
edhe kur nuk shkëlqen  
dhe besoj në dashurinë,  
edhe kur nuk është.  
Dhe besoj në Hyjin edhe kur hesht.

Besoj se për çdo provë,  
ka gjithmonë një fund,  
por nganjëherë në këtë vuajtje  
dhe dëshpërim pa shpresë  
zemra ime kërkon një strehë,  
dëshiron të dijë nëse është dikush.

Pastaj një zë ngrihet brenda meje, dhe thotë  
"Prit,  
Biri im! Do të ta jap unë forcën,  
do të ta jap unë shpresën. Ji i durueshëm  
edhe pak!"

Besoj në Diellin  
edhe kur nuk shkëlqen  
dhe besoj në dashurinë,  
edhe kur nuk është.  
Dhe besoj në Hyjin edhe kur hesht.  
Besoj se për çdo provë,  
ka gjithmonë një fund.

Se një ditë do të shkëlqejë Dielli...  
Se një ditë do të ketë lumturi...  
Se një ditë do të ketë dashuri...  
Se një ditë do të ketë paqe...

Përktheu nga versioni italisht:  
**Nikolin Sh. Lëmezhi**

# Gjama e burrave, traditë brez pas brezi

Jo vetëm një artist i njohur në nivel mbarëkombëtar, por dhe një Vajtumor i rrallë dhe i lindur në Mat e ky është Ikli Punavija nga Mat, qyteti i Burrelit.

Ikli Punavija këngën e vajit e ka ushtruar prej në moshën 17- vjeçar kur i vdiq vajza e dajës 14- vjeçe nga një sëmundje e rëndë e pa shëruar.

Pas kësaj fatkeqësie, Ikli përjetoi shumë fatkeqësi, vdekja e babait i ri, e shumë të afërt të tjerë me gjak e që Ikli ka në farefisin e tij, në fisin Punavija dhe aty ku është nip, në fisin Kolaj.

Ai ka vajtuar vetëm kur ka pasur humbje në familje, në gjakut, në gjini, në miqësisë dhe në shoqërisë, aty ku i ka takuar, dhe si i thonë një fjale, aty ku i ka qa zemra.

Në Mat ka shumë vajtoresh, si të paharruara Hanke Selita, Tushe Pasha, Zeliye Lifja, Tushe Llozhi, Kaleme Ruçi, Dila Punavija, Mihane Kola, Shane Kola, Mexhite Xhakrosa e shumë të tjera.

Haberin na e çove nepi mer i Joni / Përpara s'na dole nepi mer i Joni / Në adet të mësue nepi mer i Joni / E di nep i kujt ke



*Nga e majta në të djathtë e nga lartë poshtë: Vajtoresh e Matit: Hanke Selita, Kaleme Ruçi, Tushe Pasha e Mexhite Xhakrosa*

qan nepi mer i Joni / Ke qan nep në der të qan nepi mer i Joni / A thu nep jena të vonue nepi mer i Joni / Dajat tu kan mungue nepi mer i Joni / Ku bëhen e ku xhinen nepi mer i Joni / Oj sët në kët dit



*Vajtorja Bardhe Pjetri nga Mirdita*

nepi mer i Joni / Vijn se ju ka dek nepi, nepi mer i Joni / Nepi është Pllumb ke dajat nepi mer i Joni / Ti bijn malit me krë nepi mer i Joni / E të vijn ju ka dek nepi, nepi mer i Joni e të tjerë e të tjerë.

Vajtoresh, që janë dhe jetojnë ende në zo-

nën e Matit, janë Fazyle Hoti, Ishe Lifja, Hiqe Punavija, Behare Selita, Feride Kuleni, e shumë të tjera.

Po më i veçantë në zonën e Matit është Ikli! Ku vajton Ikli dridhet toka e shembet mali!

Mati, Mirdita, Dibra, Shkodra, e ka pasur gjithmonë traditë vajtimin, që hyn te këngët e vajit.

Në zonën e Mirditës janë shquar shumë vajtimore, që aktualisht, është Bardha Pjetri, e cila ka raste që për një ditë kërkohet në dy ceremoni mortore, pasi ku nis nana Bardhe të vajtoj i jep vërtet një karakter burrneshë dhe është vajtoresh e vërtetë dhe e rrallë në zonën e Mirditës.

A thu nan je n'gjumë tu flet / A thu je n'gjumë tu pa nai andërr / Se po t'ban nana dhandër / Po t'ban dhandërr me t'martue / Po jo, jo, jam tu gabue / Se nusja jote asht nalue / Vorri për ty asht azrue / Tokën e zezë për dyshek shtrua / Gurë e dhe për jorgan mulue... (Vajtoresh Bardhe Pjetri në Mirditë)

Mbi 7000 vjeçare Gjama e Burrave në Shkodër, vijon të mbetet traditë ndër breza.

Gjama e Burrave, sot bahet vetëm në Dukagjin të Shkodrës.

Është një që e mbështet edhe financiarisht, që është pronari i bar-restorant-hotelit "Tradita-Geg & Toske", në Shkodër, që quhet Gjon Dukgila.

E tillë ishte dhe Gjama e Burrave, në memorialin e Gjergj Kastriot-Skënderbeut, me rastin e 550 -vjetorit të vdekjes së tij, e tjetër para dy vjetësh në Muzeun Kombëtarë në Kongresin e Akademisë Shkencore rrënjët tona në Tiranë. Tjetër ishte Gjama e vërtet e bame mbi të ndjerin, "Pjetër Gjok Rrushaj", që u mbyt me gjithë djalë të vet 16- vjeçar në Bog, në një ditë të keqe me stuhi.

Disa nga emrat e njohur të Gjamës së Burrave në Dukagjinë janë: Gjon Shoshi, Nik Zogu Kir, Mhill Nika

### Disa vargje:

Kur ka ba fryma me hjek / Kan nis malet me u përpjek / Rrezja e diellit ka razi / Ujt ner kroje qënka ngri

Asht thye kulmi me qemer / Asht ba gjaku helm e vner

### Ose

Kur ka dal drita e bardh / Ka dal zani në mahall / Thon ka dek një burrë i rralle / Se ka pas shoqin në malsi / Si për duk e hijeshi / Si për mall e pasuni / Si për fjal e për pleqni

### Ka pas gra vajtoresh :

1-Cole Çunja, në Shalë / 2-Drane Gjeshlja, në Shosh / 3- Zoje Mastafja, në Shosh / 3-Katrin Tomja, në Plan

### Disa vargje :

S' po më lan lotët me t' kja / Dita terr tash mu ka ba / E kuj ja le armët e krahit / Kuj ja le nusen e shtratit

Kuj ja le kijet e kularit / Kuj ja le tubën e vathit / S'ka kush pret ma bi as mik / S'ka kush ban qiri as ferlik

.....

Tash un vajin du me pre / Te m'heret na qe t' shiem në dhe / E të tjera.....

### Prisë të gjames:

1-Pal Zef Marku nga Shala, 1-Geg Zef Delija nga Shoshi pris gjamet, 3-Ded Prel Tefa nga Gjurajt, 4-Gjon Ded Kosteri nga Shoshi

Këta janë prijesa gjame që zëvendësojnë njeri - tjetrin:

Gjamatar të spikatun ka kryesisht në Shosh, pastaj Shal, Kir-Pult e Nikaj Mertur e të tjera krahina e fshatra te Dukagjinit:

1-Ndue Fusha / 2-Gjon Fiku / 3-Kol Zefi / 4-Ndue Deda / 5-Sokol Kodra / 6-Zef Preka / 7-Gjelosh Fusha

8-Kolë Aramadhi / 9-Kolë Martini / 10-Zef Ndou / 11-Nikoll Ndoci / 12-Zef Sokoli e të tjerë...

Në zonën e Shkodrës kanë vajtuar brez pas brezi dhe e kanë traditë. Për "Gjama e Burrave", një ndër këto janë dhe Grupi

Zakonisht personat që dinë të rimojnë jetën e një personi sipas fiseve ku shkojnë në morte vajtojnë në rreshta sapo mbaron njeri grup miqësie apo gjaku fillon tjetri.

Familja dhe njerëzit e afërt qajnë pa pushim të rreshtuar rreth arkivolit, ku vijnë miqësia e vajtojnë nga larg në këmbë me rreshta dhe këto pushojnë në ndjenjë respekti.

Pasi mbarojnë vajtimin miqësia japin dorën familjarëve dhe bien mbi arkivol.

Mund përmendim disa emra grash të moshuar kohëve fundit, që kanë ditur të rimojnë dhe të vajtojnë me shpirt:

E paharruara Tushe Llozhi, Hanke Selita, Tushe Pasha, Kaleme Ruçi, Mexhite Xhakrosa, në qytetin e Burrelit kanë një kujtesë të paharruar. Duke qenë kufijar me Dibrën dhe Mirditën, duke pasur mar-



*Gjama e Burrave të Dukagjinit*

Folklorik "Besa Shoshi", në Dukagjini.

### ZONA E MATIT (IKLI PUNAVIJA).

"Një morte pa vaj si një dasmë pa këngë"

### Llojet e këngëve të vajit:

Përmenden vajtimi në këmbë po me të pritur sapo hyn në pjesën e shtëpisë derisa afrohen tek arkivoli, e i bien për rreth, vajto dhe ec 3-4 hapa, kur e pret grupi tjetër mbrapa.

Emërtimet e personave janë gjyqtari i venu (njeri i ditur, ka nda gjyq), azgan (i thuhet nipit), xhiraqin (punëtori i palodhur), në kuptimin e zanës së mirë ose malit, këto shprehje janë pjesët pas fjalëve pjesët e isos ose vargu i refrenit të përsëritur. Sot vajtojnë më thjeshtë ... "nëna e mire e imja e të tjera", kjo është zona e Derjanit dhe e Zogut, kurse zona e Lisit dhe e Klosit vajtojnë pa të pritur, kur vajton njëri, të tjerët mbajnë ison dhe mbushin zërin me vargun "ooooj nane, ose heeee nane".

Në Mat nuk ka njeri të caktuar që vajton veç, por të gjithë krahinat e fiset vajtojnë dhe ajo varet nga talenti, që ka personi për të rimuar fjalët, zakonisht përdorin mbaresat "punu, luftu, shku, duarpraru", përdoret mbaresa "ru" në vend të "uar".

rëdhënie miqësorë kemi gati të njëjta tradita. P.sh, zona e Perlatit dhe Lurës, kur Lura ka qenë pjesë e Matit.

Zonën e Derjanit ka pasur plot vajtoresh, si tek Sulkurti, Çela, Vat Doda, Skura e Pepmarku në Gjocaj, gjithashtu dhe Shelli e Lis.

### Disa vargje shkëputur nga vajtimorja e ndërë Kaleme Ruçi:

Na ka ardh ni haber i ran o azgan, or nepi mer i joni / Na asht shemb mali me na zan o azgan, or nepi mer i joni, / Na ka lujt toka nan kam o azgan, or nepi mer i joni, / A e di nep i kujt ke qan o azgan, or nepi mer i joni / Ke qan nep në derë të qan o azgan, or nepi mer i joni / A thu nep jena t'vonu o azgan, or nepi mer i joni / Mor tuj lyp e tuj kërk o azgan, or nepi mer i joni / Dajat tu mor kanë mungu o azgan, or nepi mer i joni e të tjera ...

Sot janë thjeshtuar dhe pak janë të tilla sepse dhe dyndjet pas viteve 90-të, në kohën e Demokracisë ka sjellë një përzierje popullsie dhe thjeshtim të traditave e kryesisht në këngët e vajit të pjesës folklorike.

### Gjon Kosteri -

*Anëtarë i Grupit Folklorik "Besa Shosh" Dukagjini dhe vajtimor, Shkodër, më 16 janar 2023*

# PASHKU, SHKRIMTAR I RIPAGËZIMIT TË LETËRSISË SHQIPE

Në 81-vjetorin e lindjes së Anton Pashkut (8 janar 1937-31 tetor 1995)

Me emrin dhe veprën e Anton Pashkut lidhet letërsia bashkëkohore shqiptare. Vepra e tij e ka madhështinë e shkrimtarit të së ardhmes. Ai na vjen si Modeli pashkian, që paraqet si vetëdije e pastër letrare, si vizion i rrallë në historinë e kulturës dhe të letërsisë shqiptare.

Në një pranverë shumë të hershme të moshës sime të re e kisha njohur Anton Pashkun, por jo me emrin Anton, po me emrin Nue. Isha fëmijë kur nëpërmjet bashkëshortes së kushëririt tim, që ishte motra e Anton Pashkut, e kisha takuar Antonin e me të cilin më vonë edhe jam shoqëruar.

Meqenëse vimin nga i njëjti vend (Zymi i Hasit) sa herë takoheshim përherë bisedonim për Hasin, për visin prej nga e ka prejardhjen i madhi Gjergj Kastrioti, pastaj Pal Hasi, familja Bogdani (Ndre, Pjetër, Gjon e Lukë Bogdani), bisedonim për viset ku punoi Gjon Nikollë Kazazi, Pjetër Karragiqi, Mihill Suma, Lazër Lumezi, Ndue Bytyçi, visin ku u varros Atë Luigj Palaj, ku jetoi dhe u vra Shtjefën Gjeçovi, ku u lind dhe u varros Katarina Josipi... Pra, Anton Pashku vinte nga gjiri i kulturës dhe trashëgimisë së lashtë shqiptare.

Atëbotë, me Antonin na lidhte shumëçka, kurse tash na lidhin kujtimet e ëmbla për të dhe për veprat e tij të mëdha, që ia fali kulturës shqiptare.

Anton Pashku u lind në Grazhdanik, afër Prizrenit, më 1 janar 1937. U pagëzua në Konkatedralën e Zojës Ndhimtare në Prizren, më 8 janar 1937, datë kjo që zyrtarisht edhe i mbeti si datë e lindjes. Nënë, Getë Nikë Kërhanaj (mbiemri i vajzërisë), e kishte nga Zymi, kurse babën, Tonin, nga Karashëngjergji afër Zymit.

I ati i Antonit punonte bukëpjekës, kishte punuar në Gjakovë, Prizren, Fushë-Kosovë, Prishtinë e gjetkë, andaj edhe kishte pak kohë t'i përkushtohet fëmijëve të vet – Ndout (Antonit) e Verës. Kjo kishte ndikuar që edhe Nou (Antoni) përherë të ishte i tërhequr, i vetmuar. Ai e kishte zgjedhur vetminë si në familje e po ashtu edhe në shoqëri. Vetëm gjatë pushimeve dimërore apo atyre verore Anton shkante në Zym te datat e vet – Nikë Dodë Kërhanaj.

Me mbiemrin Pashku e pagëzoi gjyshi i tij, pasi vetë e kishte mbajtur në pagëzim. Pra, gjyshi – Pashku, emrin e vet ia dha për mbiemër nipit, të cilin gjatë e kishte pritur familja të vinte në jetë. Familja e Anton Pashkut kishte zbritur në Prizren nga fshati Karashëngjergj, që në një mënyrë ishte si lagje e Zymit të Hasit. Sot më të afërmit e tij në Shëngjergj (lagja Dodaj) e mbajnë mbiemrin Kolëndrekaj, kurse pothuajse të gjithë kushërinjtë e tij, që janë shpërngulur nga katundi i përmendur e mbajnë mbiemrin Bytyçi, si dhe një pjesë e tyre e mbajnë mbiemrin Gjoni.

Antoni ishte brezi i 12 i Bytyçasëve, që

kishin ardhur nga krahina e Bëtyçit dhe që ishin vendosur në vendbanimin, që dikur njihej si Shgjeq, pastaj Bëtyç e më vonë Karashëngjergj, kurse nga tetori i vitit 1996 njihet me emrin Shëngjergj, që është afër Zymit të Hasit, komuna e Prizrenit.

Në kohën e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slovene familja e Antonit e mbante mbiemrin Gjoni, mirëpo administrata e pushtesit sllav ia kishte ndërruar në



Anton Pashku

Gjonoviq. Megjithatë, me ndërrimin e pushtesve, në vitin 1947, kur kërkohet riemërimi i familjeve, kjo familje e ktheu mbiemrin e të parëve – Kolëndrekaj (Kolë Ndreka). Këtë e bëri vetëm e vetëm për t'i ikur mbiemrit që ia kishin sllavizuar në Gjonoviq.

Gjyshi i Nout (Anton Pashkut), Pashku, me familjen e vet kishte bërë shumë lëvizje për kushte jetësore. Ai me familje ishte shpërngulur nga Shëngjergji dhe ishte vendosur në Gjakovë, pastaj në katundin Kushavec, afër Gjakovës, më vonë në Prizren e nga aty në fshatin Grazhdanik (ku u lind Nue Pashku alias Anton Pashku) dhe përsëri në Prizren. Me kalimin e familjes nga vendi në vend ata edhe e kishin ndërruar mbiemrin në Bytyçi. Nga Grazhdaniku familja e madhe Kolëndrekaj ishte ndarë. Gjysma e tyre ishte vendosur në Prizren, kurse pjesa më e madhe ishte kthyer në Shëngjergj, ku edhe tash gjenden. Ndërkaq, babai i Anton Pashkut – Toni nga Prizreni ishte vendosur në Fushë-Kosovë, ku për mbiemër e kishte marrë emrin e stërgjyshit – Pashku, andaj edhe Antoni u quajt Pashku.

Anton Pashku së bashku me motrën e vet, Verën kryesisht u rritën pa nënë. Nëna u kishte vdekur, kur Antoni i kishte shtatë vjet. I ati – Toni qe martuar tri herë. Bashkëshortja e parë i vdiq pak muaj

pasi kishte lindur një vajzë. Më pastaj Toni u martua me Getë Nikë Kërhanajn (1913-1944). Me te pati katër fëmijë – dy i vdiqën, kurse dy të tjerë (Nou alias Anton Pashku dhe Vera) u rritën. Më vonë Tonit i vdiq edhe gruaja e dytë (nëna e Anton e Vera Pashkut) e më pas Toni (i ati i Anton Pashkut) u martua për të tretën herë. Kësaj radhe me Lubicën nga Janjeva, me të cilën ka pasur pesë fëmijë.

Nue (Anton Pashku) shkollimin fillor e filloi në shkollën fillore “Bajram Curri” në Prizren, ku mësues e kishte Pal Lumezin (i njohur edhe si Pal Shkollari), që ishte me prejardhje nga Zymi e njëherësh në Prizren e kishte edhe fqinjë të parë. Po ashtu, në shtëpinë e Antonit në Prizren banonte edhe Frrok Nikë Hilë Pecolli, nga Zymi, i cili ishte mësues në fshatrat e Suharekës, i cili edhe i ndihmonte Antonit të nxente sa më shumë njohuri të reja. Pas shkollës fillore Anton Pashku e kishte filluar në Prizren gjimnazin, të cilin më vonë e kreu në Prishtinë.

Gjithë kohën punoi në “Rilindje”, njëherë gazetar, mandej redaktor i Rubrikës së kulturës e në njëzet vjetët e fundit, redaktor në Redakësinë e botimeve “Rilindja”. Shkrimet e para letrare filloi t'i botojë në revistën “Jeta e re” në vitin 1955. Me krijimtari letrare është marrë plotë 40 vjet (1955-1995).

Ka botuar edhe në revistat shkencore e letrare, si me “Jeta e re”, “Zani i rinisë”, “Dituria”, “Thema”, “Flaka e vllaznimit”, “Bota e re” e te “Fjala”. Ka qenë edhe redaktor i revistës letrare “Jeta e re” dhe revistës “Fjala”. Kryesisht ka shkruar me iniciale e më së shumti shkrimet gazetareske i ka nënshkruar me a të vogël në kllapa - (a).

Ishte anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe nga viti 1993 ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Antoni ishte martuar me Paulina Mitën, nga Prizreni, që jetonte në Prishtinë. Fëmijë i parë që u kishte ardhur në jetë kishte qenë Gjoni, i cili u kishte vdekur, kurse ky çiftë bashkëshortor ka lënë në jetë dy fëmijë: Paulinin dhe Lulen, që jetojnë në Prishtinë.

Antoni shpirtërisht ishte i lidhur ngushtë me Shëngjergjin, me Zymën, me Hasin e Thatë. Për këtë edhe fëmijët përherë i kishte mësuar të krenohen se janë zymjanë, se janë hasjanë, se rrjedhin nga ato vise shkëmbore, që e mbajnë ngjyrën e hirit, ngjyrën e gurit, ngjyrën e thatësisë...

Anton Pashku vdiq në Prishtinë, më 31 tetor 1995 dhe u varros (më 1 nëntor 1995) afër babait të vet, Tonit, në varrezat e Kishës së Shën Prenës, në katundin Karashëngjergj (Shëngjergji i sotmë).

## Veprat e Anton Pashkut:

TREGIME, “Jeta e re”, Prishtinë, 1961  
NJI PJESË E LINDJES, “Rilindja”, Prishtinë, 1965

KULLA, “Rilindja”, Prishtinë, 1968  
SINKOPA, “Rilindja”, Prishtinë, 1969  
OH, “Rilindja”, Prishtinë, 1971, 1979, 1986, 1990, “Camaj-Pipa”, Shkodër, 2003, “Berati”, Prizren, 2012

MBI KOMUNIKIMIN POETIK, “Dituria”, Prishtinë, 1972

KJASINA, “Rilindja”, Prishtinë, 1973

GOF, “Rilindja”, Prishtinë, 1976

LUTJET E MBRËMJES, “Rilindja”, Prishtinë, 1978, “Berati”, Prizren, 2011, “Piramida”, Prishtinë, 2015

TRAGJEDI FANTASTIKE, “Rilindja”, Prishtinë, 1986, 1989

TRAGJEDI MODERNE, “Rilindja”, Prishtinë, 1986

GALTINA (e përgatiti Shaip Beqiri), “Faik Konica”, Prishtinë, 2005

Shtëpia Botuese “Rilindja” në vitin 1986 i botoi veprat e zgjedhura të Anton Pashkut në tri vëllime: “TREGIME FANTASTIKE”, “OH” dhe “TRAGJEDI MODERNE”.

## Veprat e Pashkut të përkthyer në gjuhë të huaja:

PRIPOVETKE, përktheu në gjuhën serbe Vehap Shita, “Nolit”, Beograd, 1967

KJASINA, përktheu në gjuhën maqedone Luan Starova, “Misla”, Shkup, 1975

OH, përktheu në serbisht Ismet Memiç, “Prosveta”, Beograd, 1983, “Jedinstvo”, Prishtinë, 1983

KULLA / Anton Pashku. Në: The angry cloud, An anthology of Albanian stories from Yugoslavia. Prishtinë, Kosova Association of Literary Translators, 1991

THE LASSLAY UNDER THE TURKEY-OAK / Anton Pashku. Në: The angry cloud, An anthology of Albanian stories from Yugoslavia. Prishtinë, Kosova Association of Literary Translators, 1991

FLOÇKA / Anton Pashku. Në: The angry cloud, An anthology of Albanian stories from Yugoslavia. Prishtinë, Kosova Association of Literary Translators, 1991

GLÖD (Gof), përktheu në gjuhën suedeze Ullmar Qvick, Studiekamraten, Tollarp (Suedi), 1996

FIËVRE (Gof), përkthyer në gjuhën frëngje Eqrem Basha e Christiane Montecot, Petite Véhicule, Paris, 2000

FIËVRE (Gof), përkthyer në gjuhën frëngje Eqrem Basha e Christiane Montecot, L'espèce d'un instant, Paris, 2003

APARAT PROFESORA KOSA, e përgatiti për shtyp Voja Cariç, e përktheu në gjuhën serbe Halil Jupa e A. Pashku, “Rilindja”, Prishtinë, 1961

## Veprat e të tjerëve për Anton Pashkun:

Rexhep Qosja: SHKRIMTARË DHE PERIUDHA, “Instituti Albanologjik”, Prishtinë, 1975

Rexhep Murtez Shala: CD LIBRIS – antidrama e autorit, “Papyrus”, Prishtinë, 2001

Alfred Uçi: ESTETIKA E GROTESKUT: grotesku në letërsinë shqipe, "Akademia e Shkencave të Shqipërisë", Tiranë, 2001

Sabri Hamiti: LETËRSIA BASHKËKOHORE (vepra letrare 10), Libri për Antonin, "Faik Konica", Prishtinë, 2002

NË MBRETËRINË POETIKE, zgjodhi dhe përgatiti për shtyp Anton N. Berisha, "Kuvendi Salezian", Prishtinë, 2002

Kujtim Rrahmani: INTERTEKSTUALITETI DHE ORALITETI: E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, "AIKD", Prishtinë, 2002

Kujtim M. Shala: VOX-i I ANTON PASHKUT, "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2002

Nysret Krasniqi: LIBRI I PASHKUT, (romani Oh – interpretim letrar), "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2005

ANTON PASHKU – GJENIU I MODERNE, (kujtime, poezi, vlerësime, krijimtari figurative në 10-vjetorin e vdekjes), përgatiti Frrok Kristaj, Sh.B. "A. Pashku" Prishtinë e K.L. "A. Pashku" Kukës, 2005

Kujtim M. Shala: SHEKULLI I LETËRSISË SHQIPE, "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2006

Mehmet Kraja: E SHTUNA IME, publicistikë, Shpërpjestimet Pashku, "PEN Qendra e Kosovës", Prishtinë, 2009

Vjollca Dibra: MOZAIKU I JETËS MODEL I ARTIT. Poetike e tregimeve të A. Pashkut – studime, Sh.K.K. "A. Pashku", Prishtinë, 2009

Abedin Koiçi: FORMIMI I FJALËVE DHE VLERAT E TIJ NË PROZËN E STIME SHQIPE NË KOSOVË, (mbështetur në veprat e autorëve A. Pashku e R. Qosja), "Geer", Tiranë, 2011

Anton N. Berisha: VETËDËSHMI TË ISMAIL KADARESE PËR LETËRSINË, "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2013

Zana Memedi: GJUHA DHE STILI NË PROZËN E ANTON PASHKUT, "Logos-A", Shkup, 2015

ANTON PASHKU – STILIST I LIGJËRIMIT, zgjodhi dhe përgatiti Frrok Kristaj, K.L. "Shtjefën Gjeçovi", Zym-Has, 2016

Rexhep Murtez Shala: ANTIDRAMA, intervistë e improvizuar me Pashkun, "Neokultura", Prishtinë, 2016

Nysret Krasniqi: LETËRSIA E KOSOVËS 1953-2000, Autorët e letërsisë së refuzimit, "AIKD", Prishtinë, 2016

Sabri Hamiti "ANTON PASHKU" (studim), "Albas", Prishtinë, 2017

### Modeli pashkian

Anton Pashku ishte dhe mbeti shkrimtari shqiptar më i dallueshëm i këtij shekulli. Ai ishte shkrimtar i formatit të papërsëritshëm. Ishte pra, një lloj fenomeni letrar. Vepra e tij përmban shumësinë e mendimit, shumësinë figurative të fjalës dhe njëkohësisht vetëdijen e lartë estetike të ngritur deri në model. Shenjat e gjuhës së tij janë të gjuhës poetike, që e bëjnë të cilësohet dhe të mbetet shkrimtari më i veçantë i letërsisë shqiptare.

Anton Pashku për nga mënyra e krijimit ishte shumë i veçantë, sidomos për nga kodi letrar. Ishte i veçantë edhe për veprën e tij të madhe të letërsisë moderne, që mbetet model në letërsinë shqiptare – Proza (tregime, novela e roman) dhe drama e tij poetologjike mbetet e papërsëritshme dhe me vlerë gjithëkohore.

Në fakt, Pashku e solli frymën e moderne në traditën e prozës shqiptare. Ishte gjeniu i prozës moderne dhe simbol i shkrimit bashkëkohor. Veprat e tij janë të ndërtuara nëpërmjet ligjëratës – sintaksës poetike. Prandaj, edhe është shkrimtari më i realizuar artistikisht. Renditet si stilisti më i mirë në letërsinë shqiptare. Anton Pashku, ky kolos i artit letrar, në fakt, është Xhojsi, Prusti, Sartri, Orveli apo Kafka i letërsisë shqiptare.

Në tregimet e Anton Pashkut dallohen tri qarqe themelore tematike letrare; Qarku tematik i dashurisë, qarku tematik i vetmisë, dhe qarku tematik i dhunës mbi individin.

Ai paraqet një vetëdije të pastër letrare, një vizion të rrallë në historinë e kulturës dhe të letërsisë shqiptare. Anton Pashku është shkrimtar i ripagëzimit të letërsisë shqiptare të ardhmërisë, si do ta vlerëson te Sabri Hamiti.

Vlen ta përmendim faktin se aty kah vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, së bashku me një grup krijuesish të tjerë (Mensur Raifin, Gani Bobin, Ali Podrimjen e Rexhep Ismailin), ngrihet fuqimisht kundër ideologjizimit të artit, që shkaktoi trandje në krejt mjediset letrare.

### Anton Pashku i ringjallur

Menjëherë pas kalimit në amshim të Anton Pashkut, kërkova nga shumë njohës të tij të më jepnin me shkrim kujtime për të. Një pjesë e njohësve të tij, përkatësisht 21 veta m'i dhanë 31 kujtime. Në anën tjetër, shtrirja e tij (Anton Pashku) në arte (poezi, krijimtari figurative e vlerësime kritike) më shtyri që me kujdes t'i mbledhi të gjitha krijimet poetike të poetëve tanë (28 poetë kanë shkruar 35 poezi), që ia kishin kushtuar A. Pashkut nga një apo dy poezi. Mblodha edhe krijimet figurative (10 artistë figurativ kanë punuar afro 20 portrete), ku artistët figurativ në mënyrën e vet e kishin shprehur kujtimin për Antonin me ngjyra apo grafit, përkatësisht vlerësimet letrare (të mblledhura nga 59 kritikë), e të cilat, për shkaqe objektive, i kam paraqitur me nga një vlerësim të shkurtër duke i shkëputur nga vlerësimet më të gjata, të cilat i kam rënditur sipas alfabetit.

Madje, që nga dita kur Anton Pashku u nda fizikisht nga ne, për veprën e këtij shkrimtari janë shkruar dhjetëra e dhjetra libra, që lexohen me ëndje sikurse edhe vetë veprat e Pashkut. Mu për këtë Anton Pashku mbetet krijues i papërsëritshëm i letërsisë sonë kombëtare, që rileximi i veprës së tij sjell gjithmonë një zbulim të ri. Kjo edhe e bënë që Anton Pashku të

cilësohet dhe të mbetet shkrimtari më i veçantë i letërsisë shqiptare.

Njëkohësisht, pas kalimit në amshim të Antonit, ndodhi edhe ringjallja e tij nëpërmjet pagëzimit me emrin e tij të: "Ora e Anton Pashkut", që mbahet tash e 21 vjet në kuadër të manifestimit "Takimet e Gjeçovit" (manifestim ky që në vitin që shkoi (2017) u mbajt për të 46-tën here me radhë) në Zym të Hasit; Klubi letrar "Anton Pashku" në Kukës; një rrugë në Prishtinë me emrin e Pashkut, Shoqata

kulturore e Kosovës "Anton Pashku" në Prishtinë, e kështu me radhë.

Me emrin dhe veprën e Anton Pashkut lidhet zhvillimi ynë në rrugën e sigurt të letërsisë moderne shqiptare. Vepra e tij e ka madhësinë e shkrimitarit të së ardhmes. Ai paraqet një vetëdije të pastër letrare, një vizion të rrallë në historinë e kulturës dhe të letërsisë shqiptare.

Nga **Frrok Kristaj**, Zym - Has

## PSE NA DUHEN LIGJET?

Ishte ora e parë e leksionit me studentët e drejtësisë. Profesori u fut në sallën e leksioneve dhe i hodhi një shikim kërkues sallës së mbushur me studentë. Nga ai numër i madh studentësh, dukej sikur po kërkonte një njeri të veçantë. E përqendroi shikimin te një studente.

"Ju atje, në radhën e tetë. Ju lutem, a mund të më tregoni emrin tuaj?", e pyeti ai studenten. Studentja u ngrit në këmbë dhe u përgjigj: "Unë quhem Sandra." Profesori, i nervozuar i tha: "Sandra, ju lutem braktiseni menjëherë sallën e leksioneve. Nuk dua t'ju shoh në leksionin tim!" Salla ngriu, dukej sikur të gjithë studentët ndërprejnë frymëmarrjen.

Studentja mbeti e hutuar. "Shpejt, ju lutem!", bërtiti profesori, me ton të lartë. Ajo, pa guxuar të thoshte asnjë fjalë, i mblodhi gjërat e veta, i futi në çantë dhe iu drejtua derës. Profesori i hodhi një shikim të rreptë sallës. Studentët u frkësuan.

"Pse na duhen ligjet?", pyeti profesori përballë tyre. Askush nuk e hapi gojën. Të gjithë shikonin njëri-tjetrin.

"Po ju pyes juve, juristët e ardhshëm, pse na duhen ligjet?", përsëriti profesori me ton të lartë.

"Për të rregulluar marrëdhëniet sociale", foli dikush, andej nga mesi i sallës.

"Për të mbrojtur të drejtat e individit", tha dikush tjetër.

"Që gjithkush t'i besojë shtetit", shtoi dikush tjetër. Profesori tregojë shumë i pakënaqur nga përgjigjet e studentëve.

"Për të vendosur drejtësi", tha një student tjetër. Profesori qeshi. "Faleminderit zotëri!... Ashtu është. Tani më thoni, e ndëshkova unë padrejtësisht kolegen tuaj, para pak minutash? Unë gabova por, pse nuk protestoi askush nga ju? Pse nuk guxoi askush nga ju që të më ndalonte mua në ndëshkimin e padrejtë që i dhash kolegës tuaj? Pse nuk guxuat ta ndalonit këtë padrejtësi?", pyeti profesori.

Heshtje e madhe, asnjë përgjigje.

"Këtë që mësuat sot, nga veprimi i im i padrejtë me kolegen tuaj, nëse nuk do t'a kishit përjetuar, nuk do ta kishit mësuar në një mijë leksione. Ju nuk reaguat se, nuk u prekën interesat tuaja. Një qëndrim i tillë është kundër jush, kundër jetës. Ju mendoni se, për aq kohë sa nuk prekin interesat tuaja individuale padrejtësitë ndaj të tjerëve, nuk është puna e juaj.

Mbajeni mend mirë këtë që po ju them: Nëse ju nuk reagoni ndaj padrejtësive sot, pavarësisht se kush është viktimë, një ditë do të jeni ju viktimë të padrejtësisë, dhe askush nuk do t'u gjendet pranë. Drejtësia nuk është punë individësh, është e jona, e të gjithëve bashkë. Ne, të gjithë bashkë duhet të luftojmë për ta mbrojtur të drejtën. Në familje, në punë dhe kudo, duhet të jemi me fytyrë nga njëri-tjetri, jo me kurriz. Ne e ngushëllojmë veten kur problemet e të tjerëve nuk janë problemet tona. Ne shkojmë të kënaqur në shtëpi, kur e pësojnë të tjerët dhe ne nuk prekemi.

Ky është principi më i gabuar në drejtësi dhe në jetën sociale. Drejtësia mbrohet vetëm nga të gjithë bashkë, secili nga ne duhet t'i gjendet cilitdo, në rastet e padrejtësisë. Çdo ditë ndodhin disa padrejtësi ndaj njerëzve, në familje, punë mjedis dhe kudo ku ka njerëz. Të mendosh se kjo nuk është puna e ime, dhe dikush tjetër paguhet për rregullin, nuk mjafton. Është detyra jonë të jemi për tjetrin aty, edhe nëse nuk e njohim. Është detyra jonë të flasim dhe të veprojmë për tjetrin kur ai nuk ia del dot vetë. Mos harroni edhe një gjë: Ju do të jeni gjithmonë shumë dhe të pamposhtur, nëse do të jeni bashkë. Nuk ka diktator në botë që mund t'a sundojë një popull, pa ndihmën e popullit. Dhe ata që e ndihmojnë, janë masat indiferente, janë ata që mendojnë se dhimbja dhe padrejtësia ndaj tjetrit, nuk janë puna e ime". Me kaq e mbylli pprofesori leksionin e tij të parë. Studentja e "përrjashtuar" u afrua te foltorja e profesorit, duke qeshur dhe duke qarë.

Përktheu **Lekë Imeraj** - shkrimtar, përkthyes, publicist

## REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

**Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.**

Mundësoi botimin:  
**LULASH GJELOSHI**

